FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 9	2000	Prill

P Ë R M B A J T J A

Ligj nr. 8591, datë 28.3.2000	Për një shtesë në ligjin nr.7665, datë 21.1.1993 "Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin", ndryshuar me ligjin nr.8163, datë 7.11.1996 dhe ligjin nr.8368, datë 9.7.1998	365
Ligj nr.8592, datë 30.3.2000	Për emëtimin e bonove të thesarit me terma e kushte tregtare	365
Ligj nr.8593, datë 30.3.2000	Për ratifikimin e "Marrëveshjes për financim programi (Programi i zhvillimit të zonave malore) ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Ndërkombëtar për Zhvillim Bujqësor"	366
Ligj nr.8594, datë 6.4.2000	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7564, datë 19.5.1992 “Për të drejtën e autorit”	387
Ligj nr.8595, datë 6.4.2000	Për disa ndryshime në ligjin nr.8437, datë 28.12.1998 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.8507, datë 7.7.1999	389
Ligj nr.8596,	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për	390

datë 6.4.2000	sigurimin e personelit të Kombeve të Bashkuara dhe atij shoqërues"	
Ligj nr.8597, datë 6.4. 2000	Për ratifimin e "Konventës për shmangien e tatimeve të dyfishta, për tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicerane"	401
Ligj nr.8598, Datë 6.4.2000	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Agjencisë Federale Gjermane, THW, për ndihmë teknike"	417
Ligj nr.8600, Datë 10.4.2000	Për një shtesë në ligjin nr.8454, datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit"	423
Ligj nr.8601, Datë 10.4.2000	Për një ndryshim në kodin e procedurës civile të Republikës së Shqipërisë	423
Ligj nr.8602, Datë 10.4.2000	Për një ndryshim në kodin e procedurës penale të Republikës së Shqipërisë	425
Dekret nr.2597, datë 17.4. 2000	Për lënie të shtetësisë shqiptare	426
Vendim i Kuvendit Nr.428, datë 16.2.2000	Për zgjedhjen e Avokatit të Popullit	427
Vendim i Kuvendit Nr.429, datë 17.2.2000	Për caktimin e anëtarëve të komisionit të posaçëm të kuvendit për Paktin e Stabilitetit	428
Vendim i Kuvendit Nr.430, datë 17.2.2000	Për përcaktimin e raporteve të pagës, të shpërblimit dhe të normës së transportit të deputetëve	429
Vendim i KM Nr.154, datë 7.4.2000	Për licensimin e veprimtarive prodhuese në industrinë joushqimore	430
Vendim i KM Nr.186, datë 21.4.2000	Për një ndryshim në vendimin nr.326, datë 21.6.1993, të Këshillit të Ministrave, " Për kriteret e trajtimit të invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar"	431
Vendim i KM Nr.190, datë 21.4.2000	Për një ndryshim në vendimin nr.789, datë 24.12.1998, të Këshillit të Ministrave, "Për listën e barnave që rimbursohen dhe masën e mbulimit të çmimit të barnave"	432

L I G J
Nr.8591, datë 28.3.2000

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR.7665, DATË 21.1.1993 "PËR ZHVILLIMIN E ZONAVE QË KANË PËRPARËSI TURIZMIN", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8163, DATË 7.11.1996 DHE LIGJIN NR.8368, DATË 9.7.1998

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7665, datë 21.1.1993 "Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin", ndryshuar me ligjin nr.8163, datë 7.11.1996 dhe nr.8368, datë 9.7.1998 shtohet neni 6/1 me këtë përmbajtje:

"Shtyhet deri më 31.12.2001 koha e përfitimit të së drejtës për përjashtimet doganore, vetëm për qëllimin e kryerjes së investimit për investitorët që gëzojnë titullin "person i stimuluar" dhe përpara datës 7.11.1996 kanë lidhur marrëveshje zhvillimi në bazë të ligjit nr.7665, datë 21.1.1993 "Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin". Kjo shtyrje afati përcaktohet varësisht nga koha e humbur e këtyre përfitimeve, deri më datë 28.3.2000."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2590, datë 5.4.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

L I G J
Nr.8592, datë 30.3.2000

PËR EMETIMIN E BONOVE TË THESARIT ME TERMA E KUSHTE TREGTARE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Detyrimet e palës shqiptare për kapitalin e saj të papaguar në Bankën Italo-Shqiptare plotësohen nëpërmjet pagimit në cash ose emetimit të bonove të thesarit me terma dhe kushte tregtare. Emetimi i tyre bëhet në lekë, me kursin e Bankës së Shqipërisë ditën e emetimit. Termat dhe kushtet e emetimit të bonove të thesarit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2591, datë 5.4.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

L I G J
Nr.8593, datë 30.3.2000

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES PËR FINANCIM PROGRAMI (PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË ZONAVE MALORE) NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT NDËRKOMBËTAR PËR ZHVILLIM BUJQËSOR"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, dhe të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja për financim programi (Programi i Zhvillimit të Zonave Malore) ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Ndërkombëtar për Zhvillim Bujqësor".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2592, datë 5.4.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

Teksti i Negociuar
24 nëntor 1999

HUA NR 526-AL
GRANT NR.465-AL

MARRËVESHJE PËR FINANCIM PROGRAMI

(Programi i Zhvillimit të Zonave Malore)
midis
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
dhe
Fondit Ndërkombëtar për Zhvillim Bujqësor
2 janar 2000

Marrëveshje për financim programi datë 28 janar 2000 midis Republikës së Shqipërisë (huamarrësi) dhe Fondit Ndërkombëtar për zhvillim bujqësor (Fondi)

DUKE QENË SE (A) Huamarrësi ka kërkuar një hua dhe një grant nga Fondi për qëllimin e financimit të Programit të Zhvillimit të Zonave Malore përshkruar në seksionin 1 të kësaj marrëveshjeje ("Programi");

(B) Programi, përveç Komponentit të Kredisë Rurale, do të kryhet nga Agjencia për Zhvillimin e Zonave Malore (AZhZM në anglisht "MADA") dhe për këtë qëllim, Huamarrësi do të vendosë në dispozicion të MADA-s një pjesë të të ardhurave të Huasë dhe të Grantit të parashikuara në këtë dokument sipas afateve dhe kushteve të vendosura në këtë Marrëveshje;

(C) Komponenti i kredisë rurale të Programit do të kryhet nga Fondi i Financimit të Zonave Malore ("MAFF") dhe, për këtë qëllim, Huamarrësi do të vendosë në dispozicion të MAFF-it një pjesë të të ardhurave të Huasë dhe të Grantit të parashikuara në këtë dokument sipas afateve, kushteve të vendosura në këtë marrëveshje;

(D) Huamarrësi synon të marrë një grant nga Mbretëria e Hollandës, nëpërmjet Organizatës së Zhvillimit të Hollandës (SNV) ("Granti" i SNV-së) në sasinë e përafërt prej treqind e nëntëdhjetë mijë (390,000 USD) për të ndihmuar në financimin e veprimtarive të asistencës teknike të Programit mbi terma dhe kushte që do të përcaktohen në një marrëveshje ("Marrëveshja e Grantit të SNV-së") midis Huamarrësit dhe SNV-së;

(E) Huamarrësi synon të marrë nga bashkëfinancuesit financim në sasinë e përafërt prej katër milion e dyqind mijë dollarë (USD 4 200 000) për të ndihmuar në financimin e Programit sipas termave dhe kushteve që do të përcaktohen në marrëveshje midis Huamarrësit dhe bashkëfinancuesve;

(F) Huaja dhe Granti do të administrohen nga Institucioni Kooperues që do të caktohet nga Fondi; dhe;

DUKE QENË SE, mbi bazën e konsideratave të mësipërme, Fondi ka rënë dakord që të japë një Hua dhe një Grant sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje;

PRANDAJ TANI, palët këtu me anë të këtij dokumenti bien dakord si më poshtë:

Neni 1
Dispozitat e përgjithshme

SEKSIONI 1.01. *Kushte të përgjithshme.*

Kushtet e përgjithshme të Fondit për financim bujqësor të datës 2 dhjetor 1998 (këtej e mbrapa të quajtura "Kushtet e Përgjithshme") i bashkëngjiten si shtojcë kësaj marrëveshjeje, dhe të gjitha klauzolat në të (të përmendura ose jo në mënyrë të qartë këtu) bëhen një pjesë integrale prej kësaj. Nëse ndonjë klauzolë (dispozitë) është e papajtueshme me një klauzolë të Kushteve të Përgjithshme, do të mbizotërojë klauzola e kësaj marrëveshjeje, por asnjë klauzolë prej saj nuk do të kufizojë përgjithësinë e çdo klauzole të Kushteve të Përgjithshme

SEKSIONI 1.02. *Përkufizime.*

(a) Kudo që të përdoren në këtë Marrëveshje, në qoftë se konteksti nuk kërkon ndryshe, termat e përcaktuara në Kushtet e Përgjithshme dhe Hyrjen e Marrëveshjes do të kenë kuptimet e mëposhtme të parashtruara në të:

(b) Siç përdoret në këtë marrëveshje, termat e mëposhtme do të kenë kuptimet që vijojnë:

(i) "ADF" do të thotë Fondi Shqiptar i Zhvillimit

(ii) "AWPB" do të thotë çdo plan vjetor pune dhe buxhet për kryerjen e Programit gjatë një Viti të veçantë të Programit, siç përshkruhet në Seksionin 3.02;

(iii) "Institucioni Kooperues" do të thotë organi i caktuar si i tillë në seksionin 1.05;

(iv) "Vit fiskal" do të thotë çdo periudhë që fillon me 1 janar dhe përfundon me 31 dhjetor;

(v) "Agjenci udhëheqëse e Programit" do të thotë MADA dhe MAFF;

(vi) "Data e mbylljes së huasë" do të thotë data gjashtë muaj pas datës së përfundimit të Programit, ose datë e tillë e mëvonshme ashtu siç mund të caktojë Fondi me njoftimin e Huamarrësit dhe Agjencive udhëheqëse të Programit;

(vii) "Valuta për pagimin e shërbimit të huasë" do të thotë valuta e përcaktuar në seksionin 2.09;

(viii) "MADA" do të thotë Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore që do të themelohet nga Huamarrësi në përputhje me paragrafin 1.1. të Aneksit 3;

(ix) "Marrëveshje plotësuese e MADA-s" do të thotë marrëveshje midis haumarrësit dhe MADA-s të përmendur në paragrafin 1.2 të Aneksit 3, pasi e njëjta mund të përmirësohet (amendohet) ose për ndryshe të modifikohet kohë pas kohe vetëm më pëlqimin më përpara të Fondit;

(x) "MAFF" do të thotë Fondi i Financimit të Zonave Malore që do të themelohet nga Huamarrësi në përputhje me paragrafin 4.1. të Aneksit 3;

(xi) "Aktet nën ligjore së kredisë të MAFF-it" do të thotë aktet nënligjore (urdhëresat) për kryerjen e Komponentit të Kredisë Rurale të përshkruar në paragrafin 4.4 të Aneksit 3;

(xii) "Marrëveshje financimi plotësuese e MAFF-t" do të thotë marrëveshje midis Huamarrësit dhe MAFF-it në lidhje me zbatimin e Programit të përshkruar në paragrafin 4.2 të Aneksit 3, pasi i njëjti mund të përmirësohet ose përndryshe të modifikohet kohë pas kohe vetëm me pëlqimin më përpara të Fondit;

(xiii) "NDRP" do të thotë Projekti i Zhvillimit Rural të Rretheve Verilindore, financuar nga Fondi;

(xiv) "OJQ" do të thotë organizatë joqeveritare;

(xv) "Datë e përfundimit të projektit" do të thotë përvjetori i gjashtë i datës së hyrjes në fuqi, ose datë të tillë të mëvonshme, ashtu siç mund të caktojë Fondi me njoftimin e Huamarrësit dhe të Agjencive Udhëheqëse të Programit;

(xvi) "Palë e programit" përfshin (por nuk është e kufizuar ndaj) secilën agjenci udhëheqëse të programit, Ministrinë e Bujqësisë dhe agjenci të kontraktuara për qëllimin e zbatimit të programit;

(xvii)"Vit programi" do të thotë çdo periudhë e njëpasnjëshme dymbëdhjetë mujore gjatë periudhës së zbatimit të programit;

(xviii) "Llogari e veçantë A" do të thotë llogaria e përmendur në seksionin 2.03;

(xix)"Llogari e veçantë B" do të thotë llogaria e përmendur në seksionin 2.04;

(xx) "Llogari e veçantë C" do të thotë llogaria e përmendur në seksionin 2.05;

(xxi) "SSIRP" do të thotë Projekt i Riaftësimit të Veprave të Vogla Ujitëse financuar nga Fondi (Kredia Nr.372-AL);

(xxii)"Marrëveshje shtesë" përfshin (por nuk kufizohet ndaj) secilën marrëveshje plotësuese të MADA-s dhe Marrëveshjen Plotësuese Financiare të MAFF-it;

(xxiii) "Dollarë amerikanë" ose "USD" do të thotë valuta e Shteteve të Bashkuara të Amerikës; dhe

"(FKF)" do të thotë Fondi i Kreditit në Fshat.

SEKSIONI 1.03. *Referencat dhe titujt.*

Në qoftë se nuk tregohet ndryshe, referencat në këtë Marreveshje ndaj Neneve i referohen neneve, seksioneve ose Planeve të kësaj marrëveshjeje. Titujt përshkrues të neneve të tilla, seksioneve dhe planeve

jepen vetëm për lehtësi reference dhe nuk formojnë një pjesë integrale të kësaj marrëveshjeje.

Seksioni 1.04. *Detyrimet e Huamarrësit dhe Palëve të Programit.*

Sipas kësaj marrëveshjeje Huamarrësi do të jetë plotësisht i përgjegjshëm tek Fondi për ecurinë e duhur dhe në kohë të të gjithë detyrimeve që i caktohen atij, Agjencive Udhëheqëse të Programit dhe të gjitha Palëve të Programit. Në masën kur ndonjë Palë e Programit gëzon përsonalitet ligjor veçmas nga Huamarrësi, çdo referencë për një detyrim të një Pale të tillë të Programit në këtë marrëveshje do të konsiderohet një detyrim i huamarrësit për të siguruar që një Palë e tillë e Programit kryen një detyrim të tillë. Pranimi nga ndonjë palë e Programit të ndonjë detyrimi që i caktohet asaj në këtë Marrëveshje nuk do të përkë përgjegjësitë dhe detyrimet më poshtë të Huamarrësit.

Seksioni 1.05. *Caktimi i Institucionit Kooperues.*

Fondi synon të emërojë Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Shërbimet e Programeve (UNOPS) si Institucion Kooperues, me përgjegjësitë e përcaktuara në Nenin III të kushteve të përgjithshme, për administrimin e Huasë dhe Grantit dhe për mbikëqyrjen (supervizionin) në përputhje me Marrëveshjen e Bashkëpunimit. Me anë të kësaj (marrëveshje) Huamarrësi bien dakord për një emërim të tillë.

Neni 2
Huaja dhe Granti

SEKSIONI 2.01. *Huaja dhe Granti.*

Fondi bie dakord të japë:

(i) një Hua për Huamarrësin në shumën principale prej nëntë milion e gjashtëqind mijë të drejtash të veçanta tërheqjeje (SDR 9 600 000); dhe (ii) një Grant huamarrësit në sasinë themelore prej treqind e njëzetmijë të drejtash të veçanta tërheqjeje (SDR 320 000), për qëllimin e financimit të programit.

SEKSIONI 2.02. *Llogaria e huasë, Llogaria e Grantit dhe Tërheqjet.*

Fondi do të hapë një llogari Huaje në emër të Huamarrësit dhe do të kreditojë sasinë principale të Huasë në këtë llogari. Fondi do të hapë një Llogari Granti në emër të Huamarrësit dhe do të kreditojë sasinë principale të Grantit në të. Huamarrësi mund të kërkojë tërheqje ose nga Llogaria e Huasë ose nga Llogaria e Grantit midis datës së hyrjes në fuqi dhe datës së mbylljes së Huasë dhe të Grantit në valuta të ndryshme në lidhje me Shpenzime të Pranueshme dhe për ndryshe në përputhje me Planin 2 (Shpërndarja dhe tërheqja e të ardhurave të Huasë dhe të Grantit) prej saj, dhe Nenit IV (Llogaria e huasë, llogaria e Grantit dhe tërheqjet) dhe seksioni 6.02 (Valutat për Tërheqje) të Kushteve të Përgjithshme).

SEKSIONI 2.03. *Llogaria e veçantë A.*

(a) Sapo të jetë e praktikueshme, por në asnjë mënyrë jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas datës së bërjes efektive, Huamarrësi do të hapë dhe pastaj të mbajë në një bankë të pranueshme nga Fondi, një llogari të veçantë A të emëruar në USD për qëllimin e financimit të pjesës së Programit që do të ekzekutohet nga MADA. Llogaria e veçantë do të mbrohet nga pretendimi për t'u marrë (sett-off), marrja me forcë, ose bashkëngjitja (attachment) sipas termave dhe kushteve të propozuara nga Huamarrësi dhe të miratuara nga Fondi.

(b) Pasi të jetë hapur në mënyrë të duhur Llogaria e Veçantë A, me kërkesë të Huamarrësit, Fondi do të bëjë një tërheqje prej pesë qind mijë dollarë (USD 500 000), ("Shpërndarja e Autorizuar") nga Llogoria e Huasë në emër të Huamarrësit dhe të depozitojë një sasi të tillë në Llogarinë e Veçantë A. Fondi do të mbushë llogarinë e veçantë A herë pas here sipas kërkesës, në përputhje me Seksionin 4.08 të Kushteve të Përgjithshme (Llogaria e veçantë), në sasi të tilla minimale si Fondi ose, Institucioni Kooperues në emër të Fondit, mund të specifikojë me anë të njoftimit të Huamarrësit.

(c) Huamarrësi do të jetë plotësisht i autorizuar të operojë Llogarinë Speciale A në mbështetje të Seksionit 4.08 të Kushteve të Përgjithshme. Mbasi të jetë marrë Shuma e Autorizuar, Huamarrësi do të transferojë këtë shumë në një llogari të hapur nga MADA në një Bankë të pranueshme nga Fondi në lidhje me parashtrimet në seksionin 4.08 të Kushteve të Përgjithshme.

SEKSIONI 2.04. *Llogaria e Veçantë B.*

(a). Sapo të jetë e praktikueshme por në asnjë mënyrë më vonë se tridhjetë (30) ditë pas datës së hyrjes në fuqi, Huamarrësi do të hapë dhe mbas kësaj të mbajë në një bankë të pranueshme nga Fondi, një

llogari speciale B të përcaktuar në dollarë USD për qëllimin e financimit të pjesës të Programit që do të ekzekutohet nga MAFF. Llogaria e veçantë B do të mbrohet nga pretendimi sett-off, marrja me forcë (konfiskimi) ose bashkëngjitja sipas termave dhe kushteve të propozuara nga Huamarrësi dhe të pranuara nga Fondi.

(b) Pasi Llogaria e Veçantë B të jetë hapur me kërkesën e Huamarrësit në mënyrë të duhur, Fondi do të bëjë një tërheqje prej pesë qind mijë dollarë (USD 500 000), ("Shpërdarja e Autorizuar") nga Llogoria e Huasë në emër të Huamarrësit dhe të depozitojë një sasi të tillë në Llogarinë e Veçantë B. Fondi do të mbushë Llogarinë e Veçantë B herë pas here sipas kërkesës, në përputhje me seksionin 4.08 të Kushteve të Përgjithshme (Llogaria e Veçantë), në sasi të tilla minimale si Fondi, ose Institucioni Kooperues mund të specifikojnë, në emër të Fondit me anë të njoftimit të Huamarrësit.

(c) Huamarrësi do të jetë plotësisht i autorizuar të operojë Llogarinë Speciale B në mbështetje të seksionit 4.08 të Kushteve të Përgjithshme. Mbasi të jetë marrë Shuma e Autorizuar, Huamarrësi do të transferojë këtë shumë në një llogari të hapura nga MAFF në një Bankë të pranueshme nga Fondi në lidhje me parashtrimet në seksionin 4.08 të Kushteve të Përgjithshme.

SEKSIONI 2.05. *Llogaria Speciale C.*

(a). Sapo të jetë e praktikueshme por në asnjë mënyrë më vonë se tridhjetë (30) ditë pas datës së hyrjes në fuqi, Huamarrësi do të hapë dhe mbas kësaj të mbajë në një bankë të pranueshme nga Fondi, një Llogari Speciale C të përcaktuar në dollarë USD për qëllimin e financimit të pjesës së asistencës teknike të Programit që do të ekzekutohet nga MADA dhe MAFF. Llogaria e Veçantë C do të mbrohet nga pretendimi sett-off, marrja me forcë (konfiskimi) ose bashkëngjitja sipas termave dhe kushteve të propozuara nga Huamarrësi dhe të pranuara nga Fondi.

(b) Pasi Llogaria e Veçantë C të jetë hapur me kërkesën e Huamarrësit në mënyrë të duhur, Fondi do të bëjë një tërheqje prej dy qind mijë dollarë (USD 200 000), ("Shpërdarja e Autorizuar") të ndarë 125 000 USD për MADA-n dhe 75 000 USD për MAFF, nga Llogoria e Grantit në emër të Huamarrësit dhe të depozitojë një sasi të tillë në Llogarinë e Veçantë C. Fondi do të mbushë Llogarinë e Veçantë C herë pas herë sipas kërkesës, në përputhje me Seksionin 4.08 të Kushteve të Përgjithshme (Llogaria e Veçantë), në sasi të tilla minimale si Fondi, ose Institucioni Kooperues mund të specifikojnë, në emër të Fondit me anë të njoftimit të Huamarrësit.

(c) Huamarrësi do të jetë plotësisht i autorizuar të operojë Llogarinë Speciale C në mbështetje të Seksionit 4.08 të Kushteve të Përgjithshme. Mbasi të jetë marrë Shuma e Autorizuar, Huamarrësi do të transferojë këto shuma pro rata në llogaritë respektive të hapura nga MADA dhe MAFF në një Bankë të pranueshme nga Fondi në lidhje me parashtrimet në Seksionin 4.08 të Kushteve të Përgjithshme

SEKSIONI 2.06. *Përdorimi i të ardhurave.*

Huamarrësi dhe secila Palë e Programit do të përdorë të ardhurat e Huasë dhe të Grantit ekskluzivisht (posaçërisht) për financimin e Shpenzimeve të Pranueshme në përputhje me Marrëveshjen dhe Kushtet e Përgjithshme. Pa kufizuar përgjithësinë e të mësipërmes, bihet dakord dhe mirëkuptohet që është politika e Fondit që të ardhurat e Huasë dhe të Grantit të mos përdoren për të paguar taksa, duke përfshirë (por e pa kufizuar ndaj) çdo takse që vendoset në importimin, prokurimin ose furnizimin e çdo malli, vepër civile ose shërbimesh të financuara nga Huaja dhe Granti.

SEKSIONI 2.07. *Pagesa e servisit (shlyerjes së interesit të huasë).*

Huamarrësi do t'i paguaj Fondit një pagesë servisi me 0.75 % për vit mbi sasinë e mbetur të Huasë kohë pas kohe, e pagueshme dy herë në vit çdo 1 qershor dhe 1 dhjetor me valutën e pagesës së servisit të Huasë.

SEKSIONI: 2.08. *Shlyerjet e Principalit.*

Huamarrësi do të paguajë sasinë e mbetur të principalit të Huasë në 60 këste gjysmëvjetore prej 160 000 SDR, të pagueshme çdo 1 qershor dhe 1 dhjetor, duke filluar me 1 qershor 2010 dhe duke përfunduar me 1 dhjetor 2039 me valutën e servisit (shlyerjes) së huasë.

SEKSIONI 2.09. *Valuta e Servisit (shlyerjes) së Huasë.*

Për qëllimet e kësaj marrëveshjeje valuta e Shteteve të Bashkuara të Amerikës do të jetë Valuta e Shlyerjes së Huasë.

Neni 3
Programi

SEKSIONI 3.01. *Zbatimi i programit.*

Huamarrësi deklaron angazhimin e tij ndaj objektivave dhe qëllimeve të Programit të parashtruara në Nenin 1, dhe, në çuarjen më tej të objektivave dhe qëllimeve të tilla, Huamarrësi do të sigurojë që Agjencitë Udhëheqëse të Programit do të kryejnë programin:

(a) me punë të madhe dhe me efikasitet;

(b) konform me gjithë praktikat e duhura administrative; inxhinierike, financiare, ekonomike, operative, mjedisore, të zhvillimit bujqësor (duke përfshirë praktikat e zhvillimit rural) dhe të qeverisjes së mirë;

(c) në përputhje me planet, standardet e projektimit, të specifikimet, prokurimin dhe afatet e punës dhe metodat e ndërtimit të rëna dakord nga Huamarrësi dhe Institucioni Kooperues;

(d) në mënyrë të konsiderueshme në përputhje me AWPB-të;

(e) në lidhje me Komponentin e Kredisë Rurale, në mënyrë të konsiderueshme në përputhje me Statutin dhe aktet ligjore (urdhëresat) e kredisë së MAFF;

(f) përndryshe (në kushte të tjera) në përputhje me këtë Marrëveshje (në veçanti, Anekset 3 dhe 3A të saj), dhe çdo dokumenti tjetër të Huasë; dhe

(g) në një mënyrë të tillë që të sigurojë qëndrueshmëri të arritjeve të tij në kohë.

SEKSIONI 3.02. *Planet vjetore dhe buxhetet.*

(a) MADA do të konsolidojë dhe përgatisë projektplane vjetore pune dhe buxhet (AWPB) për çdo Vit Programi. Projekt AWPB-të do të përfshijnë, midis të tjerash, një përshkrim të detajuar të veprimtarive të planifikuara të Programit gjatë Vitit të ardhshëm të Programit, burimet dhe përdorimet e fondeve për të, në bazë të planeve përkatëse të punës dhe buxheteve të përgatitura nga secila nga Palët e Programit.

(b) MADA do të dërgojë projektin e AWPB në Fond dhe Institucionin Kooperues për komentet e tyre përkatese dhe miratim, jo më vonë se nëntëdhjetë (90) ditë përpara fillimit të vitit përkatës të Programit. Në qoftë se as Fondi dhe as Institucioni Kooperues nuk komentojnë mbi projektin e AWPB brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas marrjes së tij, AWPB do të konsiderohet i miratuar.

(c) MADA do të adobtojë AWPB-të në mënyrë të konsiderueshme në formën e miratuar nga Fondi dhe Institucioni Kooperues, dhe MADA do të dërgojë kopje të tij Fondit dhe Institucionit Kooperues, përpara fillimit të Vitit përkatës të programit.

(d) Nëse kërkohet, MADA mund të propozojë rregullime (përshtatje) në AWPB gjatë Vitit përkatës të Programit , të cilat do të hyjnë në fuqi me miratimin nga MADA, Institucioni Kooperues, dhe Fondi.

SEKSIONI 3.03. *Disponueshmëria e të ardhurave të Huasë dhe të Grantit.*

Huamarrësi do të vendosë në dispozicion të Agjencive Udheheqëse të Programit të ardhuravat e Huasë dhe të Grantit në përputhje me AWPB-në, Marrëveshjen Plotësuese të MADA-s dhe Marrëveshjen e Financimit Plotësuese të MAFF-it për kryerjen e programit.

SEKSIONI 3.04. *Disponueshmëria e burimeve shtesë.*

(a) Përveç të ardhurave të Huasë dhe të Grantit, huamarrësi do të vendosë konform me AWPB në dispozicion të Agjencive Udhëheqëse të Programit, menjëherë siç nevojitet, të tilla si fonde, mjete (lehtësi), shërbime dhe burime të tjera siç mund të kërkohet kohë pas kohe për kryerjen e Programit në përputhje me këtë marrëveshje.

(b) Pa kufizuar përgjithësinë e paragrafit (a) më lart, Huamarrësi do të sigurojë që të ardhurat e Grantit të SNV-së dhe financime nga bashkëfinancues të tjerë të marra prej tij, do t'i vihen në dispozicion Agjencive Udheheqëse në përputhje me AWPB-të.

SEKSIONI 3.05. *Prokurimi.*

Agjencitë udhëheqëse të Programit dhe çdo palë tjetër e Programit do të prokurojnë të gjithë mallrat, veprat civile dhe shërbimet e financuara nga Huaja dhe Granti në përputhje me Aneksit 4 të

Marrëveshjes.

SEKSIONI 3.06. *Data e përfundimit të prokurimit.*

Palët e Programit do të përfundojnë zbatimin e Programit në datën ose përpara datës së përfundimit të Projektit.

Neni 4
Raportimi i Zbatimit dhe Informacioni

SEKSIONI 4.01. *Monitorimi.*

MADA do të krijojë, sapo të jetë e praktikueshme, por në asnjë mënyre më vonë se gjashtë muaj pas datës në hyrjes së fuqi, dhe pas kësaj të mbajë një sistem të duhur të adiminstrimit të informacionit për të aftësuar atë, të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme Programin në përputhje me Seksionin 8.02 (Monitorimi i Zbatimit të Programit) të kushteve të Përgjithshme në bazë të treguesve të rëna dakord midis Huamarrësit dhe Fondit.

SEKSIONI 4.02. *Raportet e progresit (ecurisë).*

MADA, dhe MAFF përmes MADA-s, do të dërgojnë tek Huamarrësi, Fondi dhe Institucioni Kooperues raporte ecurie mbi zbatimin e Programit, siç kërkohet nga Seksioni 8.03 (Raportet e Ecurisë) të Kushteve të Përgjithshme, jo më vonë se tre muaj pas fundit të çdo periudhe gjashtëmujore gjatë periudhës së zbatimit të Programit.

SEKSIONI 4.03. *Analiza e gjysmës së periudhës (së projektit).*

(a) Huamarrësi, Fondi, Bashkëfinancues të tjerë dhe Institucioni Kooperues, do të kryejnë bashkërisht një analizë të zbatimit të Programit jo më vonë se Viti i tretë i Programit (analiza e gjysmës së periudhës) në bazë të termave të referencës të rëna dakord ndërmjet Huamarrësit, Fondit dhe Institucionit Kooperues. Midis të tjerash, Analiza e gjysmës së periudhës do të konsiderojë arritjen e objektivave të Programit dhe pengasave në të, dhe do të rekomandojë riorientim të tillë siç mund të kërkohet për të arritur objektiva të tilla dhe për të eleminuar pengesa të tilla.

(b) Huamarrësi do të sigurojë që rekomandimet që rezultojnë nga Analiza e gjysmës së periudhës së Projektit të zbatohen në mënyrë të pëlqyeshme nga Fondi. Bihet dakord dhe mirëkuptohet që rekomandime të tilla mund të rezultojnë në modifikime të Dokumentave të Huasë ose anullim të Huasë.

SEKSIONI 4.04. *Raporti i përfundimit.*

MADA do të paraqesë tek Huamarrësi, Fondi dhe Institucioni Kooperues, raportin përfundimtar të konsoliduar, mbi Programin të kërkuar nga Seksion 8.04 (Raporti Përfundimtar) i Kushteve të Përgjithshme jo më vonë se gjashtë muaj pas datës së përfundimit të Programit.

SEKSIONI 4.05. *Vlerësimet.*

Huamarrësi dhe secila palë e Programit do të lehtësojë të gjithë vlerësimet dhe analizat e Programit që mund të kryjë Fondi gjatë periudhës së zbatimit, siç kërkohet nga Seksioni 10.05 (Vlerësimet e Projektit) të Kushteve të Përgjithshme.

Neni 5
Raportimi financiar dhe Informacioni

SEKSIONI 5.01. *Pasqyrat financiare.*

MADA dhe MAFF përmes MADA-s, do të përgatisin pasqyrat financiare përfundimtare të operacioneve, burimeve dhe shpenzimeve të lidhura me Programin të kërkuara nga Seksioni 9.02 (Pasqyrat Financiare) të Kushteve të Përgjithshme në lidhje me çdo Vit Fiskal dhe t'i dërgojë këto pasqyra financiare te Fondi dhe Institucioni Kooperues brenda tre muajve pas fundit të çdo Viti fiskal.

SEKSIONI 5.02. *Raportet e revizionit.*

(a) Brenda gjashtë muajve nga data e bërjes efektive, MADA do të emërojë, me miratim paraprak të Fondit, revizore të pavarur të zgjedhur nga MADA në lidhje me procedurat dhe kriteret e rëna dakord nga Huamarrësi dhe Fondi për dy vitet e para të vitit të zbatimit të Progaramit. Pas kësaj, sapo të jetë e praktikueshme dhe në asnjë mënyrë jo më vonë se 90 ditë pas fillimit të çdo Viti fiskal të mëvonshëm, të

Programit, MADA, me miratimin paraprak të Fondit, do të konfirmojë emërimin e revizorëve të tillë ose do të emërojë në këtë mënyrë revizorë të rinj të pavarur për Vitin e Programit.

(b) Revizorët do të revizionojnë: (i) pasqyrat e konsoliduara financiare të lidhura me Programin; (ii) procedurat kontraktuese të Programit për partnerët zbatues; dhe (iii) përgjegjshmërinë e partnerëve zbatues dhe administrimin e burimeve të Programit nga partnerët zbatues në fjalë.

(c) MADA do të ketë pasqyrat e konsoliduara financiare të lidhura me programin të revizionuara për çdo vit të Programit nga revizorë të cilët janë të pranueshëm me standardet ndërkombëtare të revizionimit dhe të dërgojë një kopje të raportit të çertifikuar nga revizorët të kërkuar nga Seksioni 9.03 të Kushteve të Përgjithshme tek Huamarrësi, Fondit dhe Institucionit Kooperues brenda katër muajve mbas përfundimit të vitit të Programit.

Neni 6
Trajtimet e Fondit

SEKSIONI 6.01. *Pezullimi.*

Fondi mund të pezullojë, plotësisht ose pjesërisht, të drejtën e Huamarrësit për të kërkuar tërheqje nga Llogaria e Huasë dhe Grantit në përputhje me Seksionin 12.01 të Kushteve të Përgjithshme me ndodhjen e ndonjë prej ngjarjeve të parashtruara në të ose në ndonjë nga ngjarjet e mëposhtme:

a) Aktet ligjore të Kredisë së MAFF, ose ndonjë klauzolë në të, është hequr dorë, pezulluar, përfunduar, ose përmirësuar, ose për ndryshe modifikuar pa pëlqimin paraprak të Fondit, dhe Fondi ka përcaktuar që një heqje dorë, pezullim, përfundim, përmirësim ose modifikim i tillë ka pasur, ose ka të ngjarë të ketë, një efekt të mbrapshtë material mbi Komponentin e Kredisë Rurale.

b) Statuti i MAFF-it dhe/ose Statuti i MADA-s, ose çdo klauzolë e tyre, është hequr dore, pezulluar, përfunduar, përmirësuar ose modifikuar pa pëlqimin paraprak të Fondit, dhe fondi ka përcaktuar që një dorëheqje, pezullim, përfundim, përmirësim ose modifikim ka pasur, ose ka të ngjarë të ketë, një efekt të mbrapshtë material mbi Programin.

c) Ndonjë autoritet kompetent ka ndërmarrë ndonjë veprim për shpërbërjen e MADA-s dhe/ose të MAFF-it ose pezullimin e operacioneve të tyre, ose është filluar ndonjë veprim ose procedurë për shpërndarjen e ndonjë pasurie të MADA-s dhe ose / MAFF midis kreditorëve të tyre.

SEKSIONI 6.02. *Anullimi.*

Fondi mund të përfundojë të drejtën e Huamarrësit për të kërkuar tërheqje nga Llogaria e Huasë dhe e Grantit në përputhje me Seksionin 12.02 të Kushteve të Përgjithshme, me ndodhjen e ndonjë ngjarjeje të parashtruar në të (kushtet e përgjithshme) ose për ndonjë nga ngjarjet e mëposhtme:

(a) Analiza e gjysmës së periudhës ka rekomanduar që Programi të përfundohet.

(b) Të ketë ndodhur ngjarja e parashtruar në Seksionin 6.01 (b).

SEKSIONI 6.03. *Revizionimet.*

Nëse MADA nuk jep në kohë çdo raport që kërkohet nga Seksioni 5.02, dhe Fondi, pas konsultimit me Huamarrësin, përcakton që MADA ka të ngjarë të veprojë kështu brenda një periudhe kohe të arsyeshme pas kësaj, Fondi ose Institucioni Kooperues në emër të Fondit, mund të angazhojnë revizorë të zgjedhur prej tij për të revizionuar llogaritë e lidhura me Programin. Për një qëllim të tillë, Huamarrësi dhe palët e Programit do të vendosin në dispozicion të revizorëve të tillë, menjëherë sipas kërkesës, regjistrat e tyre financiarë dhe (regjistra) të tjerë, t'u akordojnë atyre të drejta të plota dhe privilegje si Agjentë të Fondit sipas Seksionit 10.03 (Vizitat, Inspektimet dhe Hetimet) e Kushteve të Përgjithshme dhe për ndryshe të bashkëpunojnë plotësisht me revizion të tillë. Fondi do të vendosë në dispozicion raportin e revizionimit tek Huamarrësi dhe MADA menjëherë me përfundimin e këtij (raporti). Fondi do të financojë shpenzimet e një revizioni të tillë nga tërheqje nga Llogaria e Huasë në emër të Huamarrësit, dhe me anë të këtij (dokumenti) Huamarrësi autorizon Fondin që të bëjë tërheqje të tilla.

SEKSIONI 6.04. *Trajtime të tjera.*

Trajtimet e fondit të parashtruara në këtë Nen nuk do të kufizojnë ose ndryshe të paragjykojnë ndonjë të drejtë ose trajtime të disponueshme për Fondin sipas Kushteve të Përgjithshme ose ndryshe.

Neni 7
Hyrja në fuqi

SEKSIONI 7.10. *Kushtet që paraprijnë hyrjen në fyqi.*

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në përputhje me Nenin 8 të Kushteve të Përgjithshme (Hyrja në fuqi dhe Përfundimi) duke ju nënshtruar përmbushjes së modelit të kushteve të mëposhtme:

(a) MADA të ketë qenë krijuar në përputhje me paragrafin 1.1 të Afatit 3;

(b) Drejtori ekzekutiv i MADA-s të ketë qenë emëruar në mënyrë të duhur nga MADA dhe miratuar nga Fondi;

(c) kjo Marrëveshje të ketë qenë firmosur në mënyrë të duhur, dhe firma dhe ecuria prej andej nga Huamarrësi të ketë qenë autorizuar në mënyrë të duhur dhe ratifikuar nga i gjithë veprimi i nevojshëm administrativ dhe qeveritar; dhe

(d) një opinion legal i favorshëm, lëshuar nga ministri i Drejtësisë i Huamarrësit ose këshilltar tjetër ligjor miratuar nga Fondi, në lidhje me këtë çështje parashtruar në Seksionin 7.02 në vijim dhe në formë dhe substancë të pranueshme për Fondin, do t'i dërgohet Fondit nga Huamarrësi.

SEKSIONI 7.02. *Opinioni ligjor.*

Opinioni ligjor i kërkuar nga Seksioni 7.01 do të trajtojë në mënyrë të favorshme çështjet e mëposhtme:

a) shembulli i kushtit të specifikuar në paragrafët (a), (b) dhe (c) të Seksionit 7.01 kanë qenë përmbushur; dhe

b) Kjo marrëveshje është ligjërisht e detyrueshme për Huamarrësin në përputhje me termat e saj pavarësisht nga ndonjë ligj në të kundërt në territorin e tij, dhe mbështetur nga besimi i plotë dhe kredia e (kredibiliteti) i Huamarrësit.

SEKSIONI 7.03. *Afati i fundit për hyrjen në fuqi.*

Në qoftë se kjo marrëveshje nuk hyn në fuqi brenda nëntëdhjetë (90) ditësh pas datës këtu (në marrëveshje) ose një date të mëvonshme siç mund të përcaktojë Fondi, Fondi mund të përfundojë këtë Marrëveshje dhe Dokumentet e Huasë siç parashikohet në Seksionin 13.03 të Kushteve të Përgjithshme.

Neni 8
Të ndryshme

SEKSIONI 8.01. *Përfaqësuesi.*

Ministri i Financave të Huamarrësit caktohet si përfaqësuesi i Huamarrësit për qëllimet e Seksionit 15.03 të Kushteve të Përgjithshme.

SEKSIONI 8.02. *Delegimi i kompetencave.*

(a) Huamarrësi me anë të kësaj cakton MADA-n si agjent të tij me kompetenca të plota për të ndërmarrë veprim ose për të hyrë në marrëveshje me Fondin në emër të Huamarrësit në lidhje me terheqjet nga Llogaria e huasë dhe/ ose të Llogarisë së Grantit dhe Angazhimeve të Veçanta (Seksioni 2.02 dhe Aneksi 2 prej këtej; seksionet 4.02 përmes 4.04, të përfshira, dhe 4.10 të Kushteve të Përgjithshme);

(b) Huamarrësi në vijim emëron MADA-n dhe MAFF-in si agjentë të tij me autoritet të plotë të ndërmarrë çdo veprim ose të hyjë në çdo marrëveshje me Fondin lidhur me pjesë të tyre respektive të Programit në emër të Huamarrësit në lidhje me:

(i) prokurimet (Aneksi 4 në vijim); dhe

(ii) të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e programit dhe raportimi lidhur me to (Nenet 3, 4, dhe 5, Anekset 3 dhe 3 A prej saj, Nenet 7, 8, 9 dhe 10 të Kushteve të Përgjithshme).

(c) Çdo veprim i ndërmarrë ose marrëveshje e rënë dakord nga agjente të tille sipas kompetencës së dhënë nga nënparagrafi (a) dhe (b) sa më sipër do të jetë plotësisht e detyrueshme mbi Huadhënësin dhe do të ketë të njëjtën fuqi dhe efekt sikur të ishte ndërmarrë ose rënë dakord nga Huamarrësi.

(d) Autoriteti i dhënë një agjenti të tillë me anë të këtij (dokumenti) mund të revokohet ose modifikohet vetëm me marrëveshje midis Huamarrësit dhe Fondit.

SEKSIONI 8.03. *Statusi i kësaj Marrëveshjeje.*

Huamarrësi dhe fondi bien dakord që kjo Marrëveshje përbën një traktat ndërkombëtar për të gjitha qëllimet sipa ligjit ndërkombëtar.

SEKSIONI 8.04. *Komunikimi.*

Përveç se siç shprehet qartë në Dokumentet e Huasë ose kërkohet nga Fondi, Huamarrësi ose agjenti i tij do të adresojnë të gjithë komunikimet në lidhje me këtë Marrëveshje si te Fondi, ashtu dhe te Institucionin Kooperues, përveç:

(a) kërkesave për tërheqje (bankare) (Seksioni 4.04 i Kushteve të Përgjithshme) dhe komunikimi në lidhje me prokurimin (Afati 4 i kësaj marrëveshjeje), të cilat Huamarrësi ose agjenti i tij do t'i adresojë vetëm tek Institucioni Kooperues; dhe

(b) komunikimet në lidhje me shlyerjet e servisit të huasë (Seksionet 2.06, 2.07 dhe 2.08 të kësaj marrëveshjeje, nenet 5 dhe 6 të Kushteve të Përgjithshme), të cilat Huamarrësi do t'i adresojë vetëm te Fondi.

SEKSIONI 8.05.

Adresat e mëposhtëme specifikohen për të gjitha njoftimet, kërkesat, raportet dhe komunikimet e tjera të dhëna ose të realizuara sipas kësaj marrëveshjeje:

Për Huamarrësin:
Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë, Shqipëri
Numri i Faksit: (355 42) 28494
(355 42) 29200

Kopje për:

(I) Ministrinë e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë
Bulevardi "Zhan D'Arke"
Tiranë, Shqipëri
Numri i Faksit: (355 42) 28362
(355 42) 28442

(II) Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit
Sheshi "Skënderbej", Nr.3
Tiranë, Shqipëri
Numri i Faksit: (355 42) 27924
(355 42) 28355

Për Fondin:

International Fund for Agricultural Development
Via del Serafico, 107
00142 Romë, Italy

Adresa me Cable: IFAD ROMË
Telex number: 62033 IFAD I
Numri i Faksit: (39)06 504 3463

Për Institucionin Kooperues:

United Nations Office for Project Services (UNOPS)
UNDP
405 Lexington Avenue
New York, N.Y. 10174
U.S.A

Adresa me Cable: UNOPS NEWYORK
Numri i Telex-it 662293 OPS
645495 OPS UNDP
824608 OPS UNDP
Numri i Faksit: (212) 9066501
(212) 9066502
(212) 9066904

SEKSIONI 8.06. *Gjuha e komunikimit.*

Të gjithë lajmërimet, kërkesat, raportet, dokumentet dhe informacionet e tjera që kanë të bëjnë me këtë Marrëveshje, Huaja, Granti dhe Programi (duke përfshirë raportet e nga nenet 4 dhe 5) do të jenë në gjuhën angleze.

Në dëshmi (prani) prej palëve këtu, që veprojnë përmes përfaqësuesve të tyre të autorizuar në mënyrë të duhur, kanë firmosur këtë marrëveshje në Romë, Itali, sipas datës së shkruar më parë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Përfaqësuesi i Autorizuar

Fondi Ndërkombëtar për Zhvillimi Bujqësor
Presidenti

ANEKSI 1

Përshkrimi i Programit

1. Zona e programit. Programi do të kryhet në pesëmbëdhjetë rrethe në zonën malore të territorit të Huamarrësit Tropojë, Has, Kukës, Dibër, Bulqizë, Librazhd, Skrapar, Kolonjë, Pogradec, Korçë, Përmet, Mirditë, Tepelenë, Mat, Berat dhe Pukë ("Zona e Projektit"). Huamarrësi dhe Fondi mundet, nga koha në kohë, të shtojnë rrethe të tjera që kanë zona malore.

2. Grupi i përfitues. Nga Programi do të përfitojnë familjet e zonave rurale që banojnë në zonat malore të territorit të Huamarrësit.

3. Synimi. Synimi i Programit është të rrisë standardin e jetesës së njerëzve të zonave të varfëra malore përmes rritjes së prodhimit dhe prodhimtarisë bujqësore, të një sigurie më të mirë ushqimore dhe të ushqyeri më të mirë për ekonomitë shtëpiake, të rritjes së të ardhurave nga ndërmarrjet bujqësore dhe rurale, dhe infrastrukturës së përmirësuar.

4. Qëllimet. Qëllimet e Programit janë: (a) krijimi i një Agjencie për Zhvillimin e Zonave Malore (MADA) të aftë për përpunimin e një programi zhvillimi burimesh të përdorura me efikasitet për zonat malore të Shqipërisë, duke siguruar mbështetje efikase teknike, financiare dhe drejtuese për realizimin e tij; (b) krijimin e një institucioni financiar (MAFF) për shpërndarjen e kredisë për klientët e zonave rurale, me karakteristikat e një organi plotësisht financiar, që operon kryesisht në nivelin e përgjithshëm dhe

dytësor si dhënës kredie për grupet e prodhuesve dhe shoqatave, dhe që i ofron si Qeverisë, ashtu edhe donatorëve të tjerë një kanal për kredinë të synuar për zonat malore; (c) sigurimi i një përdorimi të barabartë dhe të qëndrueshëm të ujit për ujitje, vital për jetën e fermerëve të zonave malore; (d) mbështetje për fermerët në zonat malore në veprimtaritë e tyre kryesore për nxjerrjen e të ardhurave, d.m.th prodhimit të blegtorisë përmes zhvillimit të shërbimeve veterinare të përmirësuara dhe një sistemi të qëndrueshëm të administrimit të kullotave; (e) zhvillimit të një sistemi të shërbimit këshillimor (ekstensioni) të drejtuar (demand-driven) (që funksionon në bazë të kërkesës) nga kërkesa që do të mbështesë fermerët dhe përpunuesit në zhvillimin e ndërmarrjeve të tyre të blegtorisë dhe bujqësore; dhe (f) lehtësim të bujqësisë së orientuar nga tregu dhe standardeve të përmirësuara të jetesës me anë të zbutjes së pengesave të vogla infrastrukturore përmes ndërtimit ose riaftësimit të rrugëve dhe ujësjellësave të fshatrave.

5. Komponentët. Programi do të përbëhet nga komponentët e mëposhtme:

(a) Komponenti i menaxhimit të programit. Me qëllim për të siguruar një ndikim sistematik, Programi do të krijojë një Agjenci të Zhvillimit të Zonave Malore (MADA), e cila do të jetë një lehtësi e vogël për programimin dhe planifikimin e menaxhimit të fondit. MADA do të sigurojë mbështetje me informacion, teknike, financiare dhe menaxheriale për zhvillimin e zonave malore. MADA do të veprojë si ndërmjetës midis financës së zhvillimit për zonat malore dhe të burimeve të kompetencës teknike të përshtatshme për zhvillimin e zonave malore. Mënyra e saj kryesore e punës modus operandi do të jetë të kontraktojë dhe të supervizojë (mbikëqyrë) punën, duke nxitur sipërmarrjen, efikasitetin dhe përgjegjshmërinë. Nën drejtimin e MADA-s do të krijohen katër njësi, ligjore, financiare, teknike, për zhvillim grupi dhe informacion (duke përfshirë monitorimin dhe vlerësimin). Për veç kësaj, në zonën e programit do të ngrihen katër zyra të vogla rajonale.

(b) Komponenti i kredisë rurale. Në përputhje me ligjin shqiptar, programi do të mbështesë MAFF-in të krijuar si një fondacion financiar jobankar. MAFF do të sigurojë kredi sociale dhe për prodhim bujqësor mbi një bazë të qëndrueshme për klientët që jetojnë dhe banojnë në zona të varfëra dhe margjinale. Operacionet e MAFF do të ndërtohen dhe konsolidohen mbi (nga përvoja e) veprimtaritë e shërbimit rural financiar të mbështetura nga NDRP dhe ndërhyrjet shtesë të mbështetura nga Banka Botërore. Për t'iu shërbyer nevojave të grupit të zbatimit dhe zonës së programit, MAFF do të zhvillojë një sërë kredish duke përfshirë huadhënien sociale ekzistuese për VCF-të në bazë grupi; huatë për inpute bujqësore përmes shoqatave të vogla të tregtarëve; dhe hua për shoqatat e specializuara të prodhuesve dhe agropërpunuesve të vegjël. Programi do të sigurojë asistencë teknike dhe mbështetje logjistike për MAFF.

(c) Komponenti i infrastrukturës rurale. MADA do të financojë riaftësimin e deri në 6400 ha skema të vogla ujitjeje, me gravitet. Riaftësimi do të përfshijë përmirësimin e strukturave të marrjes dhe/ose rezervuarët, kanalet kryesore të dyta, riparimin dhe zëvendësimin e mbuleseva dhe ndërtimin e strukturave për kontrollin e ujit. Përveç kësaj, programi do të financojë riaftësimin e deri 40 rrugëve rurale dhe nënprojektesh për ujësjellës fshatrash në përgjigje të kërkesës nga komunitetet e tyre përkatëse. Rrugët rurale do të financohen në rastin kur mungesa e tyre është pengesë serioze për përmirësimin e prodhimit bujqësor dhe zhvillimin ekonomik lokal. Në mënyrë të ngjashme, ujësjellësit e fshatrave do të ndërmerren aty ku nuk mund të gjenden agjenci alternative financuese dhe ku është e qartë që do të ketë një përfitim të konsiderueshëm social. Investimet do të shpërndahen gjeografikisht sipas metodologjisë synuese të Fondit Shqiptar të Zhvillimit që përfshin popullsinë dhe treguesit e varfërisë dhe që është plotësuese mbi veprat e riaftësimit të ujitjes të ndërmarra nga programi.

(d) Komponenti i zhvillimi rural. Faza fillestare e programit të zhvillimit do të përfshijnë: (a) zhvillimin dhe zbatimin e planeve të menaxhimit të komunitetit për tokën e kullotave dhe të pyjeve të përdorur për prodhim blegtoral; (b) sigurimi i fondeve për një gjurmim të gjithanshëm dhe një program vaksinimi për gjedhet dhe të imtat kundër sëmundjeve kryesore zoonotike; (c) mbështetje për zhvillimin e shërbimeve veterinare private; dhe (d) sigurimi i shërbimeve të ekstensionit (këshillimore). Veprimtaritë e administrimit dhe pyjeve dhe të pyllit do të përfshijnë transferimin e të drejtave të përdoruesit tek komunitetet, duke ndihmuar në formimin e shoqatave të përdoruesve të kullotave dhe të pyjeve, në përgatitjen dhe zbatimin e një plani administrimi. Do të marrin pjesë 10 komuna, d.m.th 100 fshatra. Veprimtaritë veterinare të programit do të nxisin dhe do të forcojnë aftësinë e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit që të përmbushë përgjegjësinë e saj statutore për kontrollin dhe çrrënjosjen e tuberkulozit,

brucelozës dhe plasjes. Përveç kësaj, do të kontraktohen veterinerë privatë duke përdorur një metodologji të NDRDP-së për të siguruar kujdes për shëndetin e kafshëve për 300 fshatra, sipas një kontrate nëpërmjet një OJQ. Për shërbim këshillimor do të zhvillohet një sistem sipas kërkesës (vënë në lëvizje nga kërkesa ose "demand-driven") në përgjigje të nevojave të parashtruara të fermerëve.Mbështetja me këshillim për zyrat e bujqësore të rretheve ose çdo partner tjetër në program do të bazohet në kërkesa të artikuluara (të qarta) dhe përmes një vlerësimi të plotë të nevojave. Sistemi do të marrë në konsideratë përpunimin e strategjive dhe politikave nga MADA dhe sigurimin e kredisë ng MAFF në lidhje me prodhimin në vreshtë dhe prodhimin e bulmetit dhe prodhimit të farave në zonat malore. Një fond i ekstensionit bujqësor në MADA do të financojë demonstrimet në fermë, programet e kualifikimit të fermerëve dhe studime. Për këtë qëllim do të kontraktohet asistencë teknike kombëtare ose OJQ.

ANEKSI 2
Shpërndarja dhe tërheqja e të Ardhurave
Të Huasë dhe të Grantit

1. Shpërndarja e të ardhurave të Huasë dhe të Grantit. Tabela e mëposhtme vendos kategoritë e shpenzimevet të pranueshme për t'u financuar nga Huaja dhe Granti, shpërndarja e sasive të Huasë dhe të Grantit për çdo kategori dhe përqindjet për zërat që do të financohen në secilën Kategori:

Kategoria	Shuma e Huasë	Shuma e Grantit	% Shpenzimeve të Huasë e Grantit		të ligjshme për t'u financuar
I. Punime Civile	2 120 000				100% të taksave neto
II. Makineri, Pajisje dhe Materialet	1 040 000				100% të taksave neto
III. Shërbimet Bujqësore	1 120 000				100%
IV. Shtesë për Kredinë	730 000				100% e nënkredive të disbursuara nga MAFF
V. Trainime dhe Studime	460 000				100% e shpenzimeve lokale
VI. Asistencë teknike:					
(a) për MAFF	-		110 000	100%	
(b) për MADA	-		210 000	100%	
VII. Shtesë për Koston Operative	1 910 000				80%
VIII. Të pa përcaktuara	2 220 000		-		
SHUMA	**9 600 000**		**320 000**		

2. Përkufizime të caktuara. Për qëllimet e këtij aneksi, termat e mëposhtme do të kenë kuptimet e mëposhtme:

(a) "punime civile" do të thotë shpenzime të tjera ligjërisht të pranueshme të lidhura me nënprojektet e rrugëve rurale, dhe të sigurimit me ujë të pijshëm të fshatrave;

(b) "shërbime bujqësore" do të thotë çdo shpenzim i ligjshëm nën paragrafin 5 (d) të Aneksit 1;

(c) "Shtesë për Koston Operative" do të thotë shpenzime të ligjëruara për pagat dhe rrogat shpenzimet e udhëtimit, kostot operative dhe të mirëmbajtjes për makinat, pajisjet, auditimin, dhe shpenzimet e zyrave; dhe

(ç) "shpenzime lokale" do të thotë çdo shpenzim i ligjshëm për shërbimet e ofruara në territorin e

Huamarrësit.

3. Sasitë minimale të tërheqjes. Tërheqjet nga Llogaria e Huasë dhe Llogaria e Grantit do të bëhet në sasi jo më pak se (20 000 USD) ose ekuivalenti i saj, ose sasi të tilla të tjera siç mund të përcaktojë Fondi kohë pas kohe.

4. Pasqyrat e shpenzimeve. Tërheqjet nga Llogaria e Huasë dhe Llogaria e Grantit në lidhje me shpenzimet mund të bëhet kundrejt pasqyrave të çertifikuara të shpenzimeve. Regjistrat që evidentojnë shpenzime të tilla nuk nevojitet të paraqiten tek Fondi, por ato do të mbahen nga MADA dhe MAFF për inspektim nga përfaqësuesit e Fondit dhe Institucionit Kooperues, në përputhje me Seksionet 4.07 (Pasqyrat e shpenzimeve) dhe 10.03 (Vizitat, Inspektimet dhe Egzaminimet (hetimet) e Kushteve të Përgjithshme.

5. Kushtet që paraprijnë tërheqjet.

(a) Nuk do të bëhet asnjë tërheqje në lidhje me shpenzimet nën Komponentin e Kredisë Rurale derisa:

(i) MAFF të ketë qenë themeluar në mënyrë të duhur dhe të funksionojë në përputhje me paragrafin 4.1 të Anekstit 3;

(ii) Marrëveshja plotësuese MAFF të jetë miratuar nga Fondi në formë projekti; një kopje e Marrëveshjes Plotësuese, si e tillë të firmoset nga Huamarrësi dhe MAFF, në mënyrë thelbësore në formën e miratuar dhe të çertifikuar si kopje e vërtetë dhe e plotë nga një specialist kompetent i MAFF-it, të jetë dorëzuar te Fondi; firma dhe realizimin prej saj nga Huamarrësi dhe MAFF të jenë autorizuar ose ratifikuar me gjithë veprimin e nevojshëm të përbashkët, adminstrativ dhe qeveritar, dhe gjithë kushtet që paraprijnë hyrjen në fuqi prej këtej të jenë përmbushur; dhe

(iii) të jetë emëruar nga MAFF drejtori i tij, që ka kualifikime dhe përvojë të pranueshme për Fondin.

(b) Nuk do të bëhet asnjë tërheqje në lidhje me shpenzimet deri sa Marrëveshja e Financimit Plotësues të MADA-s të ketë qenë miratuar nga Fondi në formën e projektit; një kopje e firmosur e Marrëveshjes së Financimit Plotësues të MADA-s, kryesisht në formën e miratuar në këtë mënyrë dhe çertifikuar si e vërtetë dhe e plotë nga një specialist kompetent i MADA-s, të ketë qenë dorëzuar te Fondi; firma dhe paraqitja e saj nga Huamarrësi dhe MADA të kenë qenë autorizuar në mënyrë të duhur ose ratifikuar me gjithë veprimin e nevojshëm të përbashkët, adminstrativ dhe qeveritar; dhe të gjitha kushtet që paraprijnë hyrjen në fuqi të saj të kenë qenë përmbushur.

ANEKSI 3

Zbatimi i programit

A. ORGANIZIMI DHE MENAXHIMI

1. MADA

1.1 Caktimi. MADA, në kapacitetin e saj si një nga Agjencitë Udhëheqëse të Programit, do të ketë përgjegjësi të plotë për zbatimin e programit. Për këtë qëllim, Huamarrësi do të sigurojë që MADA është themeluar plotësisht dhe në mënyrë të duhur si një person juridik me të drejta dhe fuqitë e nevojshme për të ekzekutuar detyrat dhe fuqitë e saj, siç specifikohet në Statutin e MADA-s dhe në këtë Marrëveshje.

1.2. Marrëveshja Plotësuese e MADA-s. Huamarrësi dhe MADA do të hyjnë në një marrëveshje (Marrëveshja Plotësuese e MADA-s), e cila do të parashikojë, midis të tjerash që:

(a) Huamarrësi do të transferojë të ardhurat e Huasë dhe të Grantit dhe burime të tjera te MADA si hua dhe grant sipas termave dhe kushteve të pranueshme nga Fondi; dhe

(b) MADA do të deklarojë angazhimin e saj për synimin dhe qëllimet e Programit siç parashtrohet në Aneksin 1 nga kjo dhe, në çuarjen më tej të objektivave dhe qëllimeve të tilla, MADA do të ndërmarrë të marrë përsipër Programin në përputhje me këtë Marrëveshje.

1.2.1. Huamarrësi do të paraqesë te Fondi dhe Institucioni Kooperues një projekt të Marrëveshjes

Plotësuese të MADA-s për komentet e tyre përkatëse dhe miratim përpara firmosjes së tij.

1.3. Përgjegjësitë. MADA do të nxisë, katalizojë, financojë, koordinojë dhe mbikëqyrë Programin. Bordi i drejtorëve të MADA-s do të takohet të paktën një herë në tre muaj. Bordi do të udhërrëfejë dhe mbikëqyrë funksionimin e përgjithshëm dhe administrimin e MADA-s, të vendosë mbi çështje të tjera të politikës lidhur me MADA-n; dhe të analizojë ecurinë e MADA-s në lidhje me Statutin e saj.

1.3.1. Në vitin e tij të parë, MADA, ndërmjet të tjerash, do të:

(a) krijojë zyrat plotësimin me personel;

(b) fillojë zbatimin e fazës së parë të Programit;

(c) hartojë një projekt plan të zonave malore;

(d) hartojë një manual të operacioneve për MADA-n;

(e) hartojnë një sistem të administrimit të informacionit për kontrollin e cilësisë, matjen e përparimit (progresit) dhe vlerësimin e ndikimit, duke përfshirë sistemet e raportimit për MADA-n dhe partnerët e saj zbatues;

(f) nxisë shërbimet e saj;

(g) identifikojë partnerët zbatues të mundshëm; dhe

(h) fillojë të marrë kërkesat e klientëvë për përfshirjen në vitin e tij të dytë të funksionimit.

1.3.2. Huamarrësi do të sigurojë që MADA të jetë në gjendje të kontraktojë si partner zbatues, departamente të Huamarrësit, NGO-s, shoqëri të sektorit privat dhe ofrues shërbimesh individuale si të përshtatshëm dhe të nevojshëm për ekzekutimin e punës së saj.

B.ZBATIMI I KOMPONËNTËVE TË PROGRAMIT.

2. Komponenti i Infrastrukturës Rurale.

2.1. Veprimtaritë e riaftësimit të ujitjes në Komponentin e Infrastrukturës Rurale do të kryhen nga SSIRP sipas marrëveshjes se zbatimit me MADA-n. Për veprimtaritë e riaftësimit të ujitjes do të përdoret metodologjia e mëposhtme: Fermerët përfitues do të ndihmohen në formimin e Shoqatave të Përdoruesve të Ujit (SHPU) dhe t'ua dorëzojnë atyre administrimin e skemave përpara ekzekutimit të ndonjë pune që është nën çadrën e Programit. Ato me vonë do të marrin pjesë plotësisht në projektimin dhe riaftësimin e skemave të tyre të ujitjes. Aty ku është e përshtatshme do të krijohen federatat e SHPU-ve (F/SHPU). Kritere të pranueshmërisë për riaftësimin e skemës do të përfshijnë furnizimin e ujit me gravitet dhe mundësinë e përfaqësimit të grave në bordin e Shoqatave të përdoruesve të Ujit. MADA do të kontraktojë kryesisht ADF (Fondin e Zhvillimit Shqiptar) për ekzekutimin e projekteve të vogla të infrastrukturës. Për çdo nënprojekt komunat do të ndihmojnë përdoruesit të formojnë komitetet e përdoruesve. Pas miratimit, do të firmosen kontrata midis ADF ose agjencive të tjera, komitetit të komunës dhe të përdoruesve për të përcaktuar kuadrin e punës, kohën, mirëmbajtjen në të ardhmen dhe kontributin nga përdoruesit.

3. Komponenti i zhvillimit bujqësor

3.1. Nënkomponenti i administrimit të kullotave dhe pyjeve do të kontraktohet nëpërmjet MADA-s, Projektit të Pyjeve në vazhdim të financuar nga Banka Botërore dhe donatorë të tjerë.Drejtori i Njësisë së Menaxhimit të Projektit të Pyjeve do të ketë përgjegjësinë e përgjithshme për zbatimin e këtij nënkompetenti, duke përdorur strukturën e tanishme të provuar dhe metodologjinë e projektit.

3.2. Shërbimi veterinar i Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit (MBU) do të jetë përgjegjës për zbatimin e programit për kontrollin e sëmundjeve zoonotike dhe epidemike. Nën përgjegjësinë e Shërbimeve Veterinare të rretheve, do të kontraktohen veterinerë privatë për të kryer programin e vaksinimit. Për çdo kafshë të trajtuar, veterinerit privat do t'i jepet një pagesë, ndërsa kostoja e reagentëve dhe vaksinave do të sigurohet përmes Programit. Përgjegjësia për zbatimin e Programit të mbështetjes për shërbimet veterinare private do t'i kontraktohen një OJQ-je me përvojë në fushën e kujdesit për shëndetin veterinar. OJQ-të e kualifikuara do të paraqesin një propozim në bazë vjetore për analizë dhe përzgjedhje nga MADA. OJQ-të e kontraktuara nga ana e tyre do të kontraktojnë veterinerë privatë për të kryer programin e vaksinimit dhe të mjekimit. Veprimtaria do të kryhet mbi bazën e një kostoje rrëshqitëse shlyerjeje.

3.3. Zbatimi i veprimtarive të shërbimit këshillimor, të mbështetura nga programi përfshirë dhe iniciativat e marketingut do të dalin fillimisht nga gjetjet (rezultatet) e një vëzhgimi të nevojave fillestarë të Programit, të ndihmuara nga konsultime të mëtejshme me përfitues të mundshëm nga Drejtoritë e Bujqësisë së Rretheve. Në përgjigje të nevojave të parashtruara për shërbim këshillimor nga përfituesit e mundshëm MADA, atëherë do të ketë përgjegjësinë për zhvillimin e strategjive dhe të politikave në tema të tilla si administrimi i kullotave dhe zhvillimi i prodhimit të vreshtave, prodhimit të bulmetit, dhe prodhimit të farërave në zonat malore. Ku është e nevojshme, do të kontraktohen specialistë të pavarur, OJQ ose agjenci të tjera të kualifikuara për të kryer studime vijuese dhe programe eksperimentale. Përdorimi i fondeve të MADA-s për ekstensionin do t'u jepen aplikimeve që i janë bërë MADA-s. Aplikantët e pranueshëm do të jenë grupe fermerësh/prodhuesish dhe shoqata, tregtarë privatë dhe agrobisznese të vogla të tillë si prodhues farërash, OJQ dhe zyra bujqësore të rretheve.

4. Komponenti i kredisë rurale

4.1. Caktimi i palës së programit. Komponenti i kredisë rurale do të kryhet nga MAFF. Huamarrësi do të sigurojë që MAFF të krijohet plotësisht dhe ligjërisht si një fondacion financiar jobankar për qëllimin e administrimit të kredisë rurale në zonën e Programit.

4.2. Marrëveshja Plotësuese e Financuese e MAFF. Huamarrësi do të hyjë në marrëveshje me MAFF, e cila do të sigurojë, midis të tjerash, që:

(a) Huamarrësi do të transferojë fonde të disponueshme të Komponentit të Kredisë Rurale tek MAFF si hua në përputhje me AWPB dhe sipas termave dhe kushteve të pranueshme për Fondin; dhe

(b) MAFF do të deklarojë angazhimin e saj për synimet dhe qëllimet e Programit siç parashtrohet në Aneksin 1 dhe, për çuarjen më tej të synimeve dhe qëllimeve të tilla, ai do të ndërmarrë që të kryejë Komponentin e Kredisë Rurale në përputhje me këtë marrëveshje dhe aktet nënligjore të MAFF, të cilat do t'i bashkëngjiten Marrëveshjes Plotësuese të financimit të MAFF.

4.3. MAFF do të administrohet në përputhje me Statutin dhe rregulloret e saj dhe procedurat funksionale të pranueshme për Huamarrësin dhe Fondin. Të gjitha operacionet huadhënëse dhe shërbimet e fushës do të administrohen nga departamenti i shërbimeve të saj financiare. Fillimisht, operacionet në fushë do të përqendohen në operacionet e NDRP-së dhe në zgjerime eksperimentale (pilote) në zonat e SSRP. Për zgjerimin e Programit, do të sigurohen shërbime për zhvillimin e grupeve në një bazë kontraktuale përmes MADA-s si për VCF-të ekzistuese, ashtu dhe VCF-të e sapo formuara. MAFF do të sigurojë vetëm kredi të mbikëqyrur (supervizuar) me përjashtim të programit të kredisë VCF, e cila do të përqendrohet kryesisht në huadhënien sociale për komunitetet me disavantazhe dhe, e cila, do të shtrihet në gjithë zonat malore. Duke qenë se MAFF do të jetë plotësisht institucion financiar, MADA do të sigurojë mbështetje për zhvillimin e grupit huamarrës mbikëqyerjes, si dhe huamarrësve do t'u sigurohen shërbime teknike. Këto shërbime përfshijnë, nga njëra anë, formim grupi, menaxhim, mbikëqyerje (supervizion), revizionim dhe kualifikim në hartimin e planeve të biznesit për paraqitjen te MAFF si pjesë e procesit të kërkesës për nënhua, nga ana tjetër, kualifikim teknik, p.sh. për përpunimin e bulmetit ose prodhimin e perimeve.

4.4. Aktet nënligjore të kredisë. MAFF do të përgatisë draftet e akteve nënligjore të kredisë, të pranueshme për Fondin, sa më shpejt të jetë e pranueshme, por jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas datës së bërjes efektive.

4.4.1. MAFF do të aprovojë aktet nënligjore të kredisë së MAFF-it, kryesisht në formën e miratuar nga Fondi, për kërkesën (aplikimin) për të gjitha nënkreditë të dhëna përfituesve të Programit që janë financuar (drejtëpërdrejtë ose indirekt) nga Huaja ose Granti. MAFF duhet të dërgojë kopje të tyre Fondit dhe Institucionit Kooperues menjëherë pas miratimit.

4.5. Fondi i Qarkullues. Në konsultim me Institucionin Kooperues, MAFF do të krijojë dhe mbajë një Fond Qarkullues në të cilin të do të depozitohen të gjitha të ardhurat neto nga nënkreditë dhënë përfituesve të Programit financuar (direktet ose indirekt) nga Huaja ose Granti të cilat duhet të depozitohen. MAFF do të përdorë Fondin Qarkullues për të financuar më tej nënkreditë për përfituesit e Programit në përputhje me këtë Marrëveshje të paktën deri sa një datë e tillë, siç do të specifikohet në Marrëveshjen Plotësuese të Financimit të MAFF-it ose, nëse nuk është specifikuar një datë në këtë mënyrë, deri sa shlyerjet e huasë të jenë përfunduar plotësisht. Për qëllimet e këtij paragrafi, termi 'të

ardhurat neto" do të thotë të gjithë shlyerjet e principalit dhe të gjitha pagesat e interesit, pa shpenzimet e arsyeshme operative dhe shpenzime të tjera.

ANEKSI 3 A
Angazhime të tjera të huamarrësit

1. Praktikat e kontrollit të kandrave (pest management). Si pjesë e ruajtjes së një mjedisi të shëndoshë siç kërkohet nga Seksioni 7.15 i Kushteve të Përgjithshme, Palët e programit do të mbajnë praktika të duhura të menaxhimit administrimit të kandrave, dhe për këtë qëllim, Huamarrësi do të sigurojë që pesticidet e prokuruara nën këtë program të mos përfshijnë asnjë pesticid ose të ndaluara nga Kodi Ndërkombëtar i Sjelljes (International Code of Conduct) mbi shpërndarjen dhe përdorimin e pesticideve të Organizatës Botërore të Bujqësisë dhe Ushqimit (FAO), siç përmirësohet herë pas here, ose shënohet në Tabelat 1 (Tepër të rrezikshme) extremely hazardous] dhe 2 (shumë të rrezikshme) highly hazardous] të Klasifikimit të Rekomanduar të Pesticideve të OBSH-së (WHO) me rrezik dhe klazifikim (1996 – 1997), siç përmirësohen nga koha në kohë.

2. Sigurimi i Personelit të Programit. MADA dhe MAFF do të sigurojnë personelin kyç të programit kundër rreziqeve shëndetësore dhe aksidenteve në masën e pajtueshme me praktikën e shëndoshë komerciale.

ANEKSI 4
Prokurimi

PJESA A
E PËRGJITHSHME

1. Prokurimi i mallrave dhe veprave civile të financuara nga Huaja dhe Granti do t'i nënshtrohet klauzolave dhe Udhëzimeve për Prokurimin nën Asistencën Financiare nga Fondi Ndërkombëtar për Zhvillim Bujqësor i Vitit 1982", pasi udhëzime të tilla mund të përmirësohen kohë pas kohe nga Fondi (këtej e prapa e quajtur "udhëzimet e prokurimit"). Nëse ndonjë udhëzim i Prokurimit është i papërputhshëm me klauzolën e këtij Plani, atëherë do të ketë fuqi e dyta.

2. Prokurimi i shërbimeve konsulente nga të ardhurat e Huasë dhe Grantit do të ndërmerret në përputhje me procedurat e Institucionit Kooperues për prokurimin e shërbimeve konsulente për Projekte dhe Programe të ngjashme.

3. Deri në masën sa të jetë e mundur, mallrat, veprat civile dhe shërbimet do të vendosen në paketa me masë në një mënyrë të tillë që të lejojnë përdorim optimal të ofertave konkuruese. Përpara fillimit të prokurimit, Huamarrësi do t'i japë Institucionin Kooperues për miratim: (i) një listë ose listat e mallrave që do të prokurohen; (ii) grupimin e propozuar të mallrave dhe të shërbimeve; dhe (iii) numrin e propozuar dhe kuadrin e kontratave të veprave civile që do të jepen.

4. Prokurimi do të ndërmerret vetem gjatë periudhës së zbatimit të Programit.

5. Nuk do të ndërmerret asnjë prokurim nëse ai ka të bëjë më një pagesë për persona ose organe, ose nje import mallrash, të ndaluara nga një vendim i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara sipas Kapitullit IV të Statutit të Kombeve të Bashkuara. Fondi do të informojë Huamarrësin për çdo person, organ ose import të tillë.

6. Sasitë e pragut, të specifikuara në këtë Aneksin 4 përfshijnë taksat.

PJESA B
PROKURIMI I MALLRAVE

7. Tenderimi (ofrimi) lokal konkurues (LCB). Çdo kontratë për furnizimin e mallrave dhe

pajisjeve të përllogaritura të kushtojnë më shumë se 25 000 USD ekuivalent do të jepen në bazë të tenderimit lokal të reklamuar në vend, në përputhje me procedurat e Huamarrësit të miratuara nga Institucioni Kooperues.

8. Blerja (shopping-u) ndërkombëtar. Në mënyrë alternative, ç'do kontratë për furnizimin e mallrave dhe të pajisjeve të përllogaritura më shumë se 25 000 USD ekuivalent mund të jepen mbi bazën e vlerësimit dhe krahasimit të ofertave të ftuara nga të paktën tre furnizues të pranueshëm sipas kësaj marrëveshjeje, në përputhje me procedurat e miratuara nga Institucioni Kooperues.

9. Blerja (shopping) lokale. Çdo kontratë për furnizimin e mallrave dhe të pajisjeve që do të kushtojë më shumë se 25 000 USD ekuivalent ose me pak mund të jepen mbi bazën e vlerësimit dhe krahasimit të ofertave të ftuara nga të paktën tre furnizues të pranueshëm në përputhje me procedurat e miratuara nga Institucioni Kooperues.

10. Kontraktimi i drejtëpërdrejtë. Në mënyrë alternative, çdo kontratë për furnizimin e mallrave dhe pajisjeve e përllogaritur të kushtojë 25 000 USD ose më pak mund të jepet nëpërmjet kontraktimit të drejtpërdrejtë me kontraktuesin ose furnizuesin sipas termave dhe kushteve të miratuara nga Institucioni Kooperues.

PJESA C
PROKURIMET E PUNIMEVE CIVILE

11. Tenderimi (ofrimi) konkurues lokal (LCB). Çdo kontratë për furnizimin e veprave civile dhe për riaftësimin e skemave të vogla të ujitjes dhe rrugëve rurale e përllogaritur të kushtojë më shumë se 25 000 USD ekuivalent do të jepet mbi bazën e tenderit të reklamuar në vend, në përputhje me procedurat e miratuara nga Institucioni bashkëpunues.

PJESA D
PROKURIMET E SHËRBIMEVE

12. Prokurimi i shërbimeve. Në prokurimin e shërbimeve konsulente, duke (supozuar) qenë të gjithë të barabartë, përferencë do t'u jepet konsulentëve nga Shtetet Anëtare të Fondit nga vendet në zhvillim.

PJESA E
RISHIKIMI I VENDIMEVE TË PROKURIMIT

13. Dhënia e kontratës për mallrat ose veprat civile të përmendura në paragrafët 7, 8 dhe 11 më lart të përllogaritura të kushtojnë më shumë se USD 25 000 ekuivalent do t'i nënshtrohen analizimit paraprak nga Institucioni Kooperues në përputhje me klauzolat e Shtojcës 3 të Udhëzimeve të Prokurimit.

14. Dhënia e çdo kontrate për shërbime konsulente të përmendura në paragrafin 2 më lart e përllogaritur të kushtojë më tepër se 25 000 USD ekuivalent do t'i nënshtrohet procedurave të analizimit pasi Institucioni Kooperues zakonisht zbaton kontrata të tilla në Projekte dhe Programe të ngjashme.

15. Për çdo kontratatë për mallrat, veprat civile ose shërbimet civile, Huamarrësi do të japë dy kopje të çertifikuara ose konform kopjeve të kontratave të tilla të Institucionit Kooperues, së bashku me analizën e ofertave përkatëse dhe rekomandimeve për dhënien, menjëherë pas firmosjes së saj dhe përpara paraqitjes tek Institucioni Kooperues të kërkesës së parë për tërheqjen e fondeve dhe nga Llogaritë e Huasë ose të Grantit në lidhje me një kontratë të tillë.

16. Përpara rënies dakord për çdo modifikim material ose dorëheqjes prej termave dhe kushteve të çdo kontrate të përmendur në paragrafet 13 dhe 14 më lart, ose dhënies së një zgjerimi të kohës së specifikuar për kryerjen e një kontrate të tillë, ose lëshimit të çdo rregulli ndryshimi nën një kontrate të tillë (përveç në rastet e urgjencës së madhe) që do të rrisnin shpenzimet e kontratës me më shumë se 10% të çmimit fillestar, Huamarrësi do të informojë Institucionin Kooperues për modifikimin e propozuar, dorëheqjen, zgjatjen ose rregullin e ndryshimit dhe arsyet për këtë. Nëse Institucioni Kooperues

përcakton që propozimi do të ishte i papajtueshëm me klauzolat e kësaj marrëveshjeje, do të informojë menjëherë Huamarrësit dhe të parashtrojë arsyet për përcaktimin e saj.

L I G J
Nr.8594, datë 6.4.2000

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7564, DATË 19.5.1992 "PËR TË DREJTËN E AUTORIT"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr.7564, datë 19.5.1992 "Për të drejtën e autorit" bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 1 shkronja "a" ndryshohet si vijon:
"a) Vepra të shkruara, duke përfshirë edhe programe kompjuteri të shprehura në kod burimor ose në kod objekt."

Neni 2

Titulli i nenit 2 ndryshohet si vijon:
"Vepra të prejardhura dhe koleksione."

Neni 3

Titulli i nenit 18 ndryshohet si vijon:
"Kohëzgjatja e mbrojtjes së veprave anonime ose me pseudonim"

Neni 4

Në nenin 37, në pikën 3 shkronja "b", fjalët "… e nenit 39…" zëvendësohen me fjalët "… e nenit 38…"

Neni 5

Neni 50 ndryshohet si vijon:
"Përkthimi, përshtatja, regjistrimi viziv ose auditiv, importimi, riprodhimi dhe vënia në qarkullim, futja e aparaturave të posaçme për riprodhim zëri dhe figure, transmetimi në radio e televizion ose në çfarëdo sallë ose me çdo mjet tjetër të pronësisë artistike, pa lejen e autorit ose të shoqatës së cilës ia ka kaluar të drejtat, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji apo të marrëveshjes ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, kur janë shkelur të drejtat morale dhe ekonomike të autorit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 1 vit.

Mosmarrëveshjet ndërmjet përdoruesit të veprës së pronësisë intelektuale dhe autorit ose shoqatës, të cilës i ka kaluar e drejta e tij, për mospërmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata e lidhur ndërmjet tyre, i paraqiten gjykatës përkatëse nga pala e interesuar për shqyrtim civil."

Neni 6

Neni 51 ndryshohet si vijon:

"Dispozitat e këtij ligji u referohen:

a) veprave, autorët e të cilave janë me shtetësi shqiptare ose me banim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, pavarësisht nga vendi ku janë botuar për herë të parë;

b) veprave të botuara për herë të parë në Shqipëri ose në një shtet që është palë në marrëveshje ose në traktate ndërkombëtare për të drejtat e autorit, ku bën pjesë edhe Republika e Shqipërisë;

c) veprave të botuara për herë të parë në një shtet që nuk është palë në një marrëveshje ose në traktate ndërkombëtare për të drejtat e autorit, në të cilat merr pjesë Republika e Shqipërisë, në rastet kur këto vepra janë botuar njëkohësisht ose deri në 30 ditë diferencë në territorin e atij shteti dhe në Republikën e Shqipërisë ose në një vend tjetër anëtar në marrëveshjet ndërkombëtare, ku merr pjesë edhe Republika e Shqipërisë.

ç) veprave që janë krijuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji, me kusht që të mos t'u ketë kaluar afati i mbrojtjes që përmendet në këtë ligj."

Neni 7

Neni 52 ndryshohet si vijon:

"Ngarkohen Këshilli i Ministrave, Ministria e Financave, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës të hartojnë aktet nënligjore përkatëse për zbatimin e këtij ligji."

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2601, datë 19.4.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

L I G J
Nr.8595, datë 6.4.2000

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8437, DATË 28.12.1998 "PËR AKCIZAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8507, DATË 7.7.1999

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr.8437, datë 28.12.1998 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin

nr.8507, datë 7.7.1999 bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3, në kapitullin 33, në Kodin N.C. 33.3.0090, në pikën "F", fjala "Deodorante" zëvendësohet me fjalët "Ujëra tualeti".

Neni 2

Neni 4 ndryshohet si vijon:

"Për mallrat e prodhuara në vend, akciza e të cilave paguhet me përqindje, llogaritja e akcizës bëhet në bazë të çmimit para tatimit.

Për mallrat e importuara, akciza e të cilave paguhet me përqindje, llogaritja e akcizës bëhet në bazë të vlerës doganore plus taksën doganore".

Neni 3

Neni 10 ndryshohet si vijon:

"Shkeljet e parashikuara në nenin 9 të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale formojnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si vijon:

- Fshehja dhe falsifikimi i akcizave përveç detyrimit të pagimit të akcizës dënohet edhe me një gjobë të barabartë me shumën e kësaj akcize.
- Mbajtja e gabuar e llogarive dënohet me gjobë nga 5 000 (pesë mijë) deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë.
- Për derdhjen me vonesë të akcizave në buxhetin e shtetit, paguhen interesa për pagesë të vonuar në përputhje me ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".
- Mosparaqitja në kohë e deklaratës periodike mujore për akcizat e realizuara, dënohet me gjobë 6 000 (gjashtë mijë) deri në 8 000 (tetë mijë) lekë.

Procedurat e ankimit dhe të ekzekutimit të masës administrative bëhen në përputhje me ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"".

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2602, datë 19.4.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Mediani.

L I G J
Nr.8596, datë 6.4.2000

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË "KONVENTËN PËR SIGURIMIN E PERSONELIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA DHE ATIJ SHOQËRUES"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, dhe të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në "Konventën për sigurimin e personelit të Kombeve të Bashkuara dhe atij shoqërues".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2603, datë 19.4.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

KONVENTA PËR SIGURIMIN E PERSONELIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA DHE ATIJ SHOQËRUES

Asambleja e përgjithshme

Duke menduar se kodifikimi dhe zhvillimi progresiv i së drejtës ndërkombëtare kontribuon në vënien në jetë të qëllimeve dhe të parimeve të përcaktuar në nenin 1 dhe 2 të Kartës së Kombeve të Bashkuara,

Seriozisht të shqetësuara për shtimin e numrit të sulmeve mbi personelin e Kombeve të Bashkuara dhe atij shoqërues, që ka shkaktuar vdekjen ose dëmtimin e rëndë,

Duke patur parasysh se operacionet e Kombeve të Bashkuara mund të kryhen në situata që paraqesin rrezik për sigurimin e personelit të Kombeve të Bashkuara dhe atij shoqërues,

Duke njohur nevojën e forcimit dhe të mbajtjes parasysh të marrëveshjeve për mbrojtjen e personelit të Kombeve të Bashkuara dhe atij shoqërues,

Duke u mbështetur në rezolutën e saj 48/37 të datës 9 dhjetor 1993, nga e cila u krijua Komiteti Ad Hoc për përpunimin me kujdes të një Konvente Ndërkombëtare lidhur me sigurimin e personelit të kombeve dhe atij shoqërues, me referim të veçantë për përgjegjësinë për sulmet mbi këtë personel.

Duke marrë në konsideratë raportin e Komitetit Ad Hoc, në veçanti tekstin e përpunuar gjatë bisedimeve, të rezultuar nga puna Ad Hoc,

Duke patur parasysh vendimin e saj, në përputhje me rekomandimin e Komitetit Ad Hoc, të rikrijojë, në sesionin e tanishëm, një grup pune brenda strukturës së Komitetit të të Gjashtëve për vazhdimin e shqyrtimit të tekstit të përpunuar gjatë bisedimeve dhe për më tepër të propozimeve përkatëse,

Duke shqyrtuar tekstin e projekt konventës që u përgatit nga grupi i punës dhe iu paraqit Komitetit të të Gjashtëve për shqyrtim me synim adoptimin e tij,

1. Adopton dhe hap për nënshkrim dhe ratifikim, pranim ose aprovim, ose për aderim, Konventën për Sigurimin e personelit të Kombeve të Bashkuara dhe atij shoqërues, teksti i së cilës është në aneksin e kësaj rezolute,

2. I bën thirrje shteteve të marrin të gjitha masat e përshtatshme që të garantojnë sigurimin e Personelit të Kombeve të Bashkuara dhe atij shoqërues brenda territorit të tyre,

3. Rekomandon që Sigurimi i Personelit të Kombeve të bashkuara dhe atij shoqërues të mbahet vazhdimisht parasysh nga strukturat përkatëse të Organizatës,

4. Nënvizon rëndësinë që ajo i jep përfundimit të shpejtë të një përmbledhje të plotë të marrëveshjeve për kompensim për vdekje, paaftësi, dëmtim ose sëmundje që i atribuohen shërbimit paqeruajtës, me synimin që të zhvillojë marrëveshje të përshtatshme dhe të sigurojë rimbursim të përshtatshëm.

ANEKS

KONVENTA MBI SIGURIMIN E PERSONELIT TË KOMBEVE
TË BASHKUARA DHE ATIJ SHOQËRUES

Shtetet palë në këtë Konventë,

Thellësisht të shqetësuara për rritjen e numrit të vdekjeve dhe dëmtimeve që rezultojnë nga sulmet e paramenduara kundër personelit të Kombeve të Bashkuara dhe atij shoqërues,

Duke patur parasysh se sulmet ose keqtrajtimet e tjera të personelit që vepron në emër të Kombeve të Bashkuara janë të pajustifikueshme dhe të papranueshme, nga kushdo që kryhen,

Duke njohur se operacionet e Kombeve të Bashkuara janë kryer në interesin e përbashkët të komunitetit ndërkombëtar dhe në përputhje me parimet dhe qëllimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara,

Duke pranuar kontributin e rëndësishëm që personeli i Kombeve të Bashkuara dhe ai shoqërues japin përsa i përket forcave të Kombeve të Bashkuara në fushat e diplomacisë parandaluese, vendosjes së paqes, ruajtjes së paqes dhe operacioneve të tjera,

Të ndërgjegjshëm për marrëveshjet ekzistuese për sigurimin e personelit të Kombeve të Bashkuara dhe atij shoqërues, duke përfshirë hapat e që janë marrë nga organet kryesore të Kombeve të Bashkuara në këtë drejtim,

Duke pranuar, megjithatë, se masat ekzistuese për mbrojtjen e personelit të Kombeve të Bashkuara dhe atij shoqërues janë të pamjaftueshme,

Duke njohur se efektiviteti dhe sigurimi i operacioneve të Kombeve të Bashkuara rritet kur operacione të tilla janë kryer me pëlqimin dhe bashkëpunimin e shtetit pritës,

Duke i bërë thirrje të gjitha shteteve në të cilët është dërguar Personeli i Kombeve të Bashkuara dhe ai shoqërues, si dhe të gjithë të tjerëve në të cilët një personel i tillë mund të mbështetet, që t'i japin mbështetjen e nevojshme që ndihmon në kryerjen dhe përmbushjen e mandatit të operacioneve të Kombeve të Bashkuara,

Të bindur se ekziston një nevojë urgjente për adoptimin e masave të përshtatshme dhe efektive për ndalimin e sulmeve që kryhen kundër personelit të Kombeve të Bashkuara dhe atij shoqërues dhe për ndëshkimin e atyre që kryejnë sulme të tilla,

Neni 1
Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Konvente:

a) **"Personeli i Kombeve të Bashkuara"** nënkupton:

1. Personat e punësuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara si pjesëtarë të komponenteve ushtarake, policore dhe civile të operacioneve të Kombeve të Bashkuara;

2. Zyrtarë dhe ekspertë të tjerë të Kombeve të Bashkuara ose të Agjencive të saj të Specializuara ose të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike që janë aktualisht në cilësi zyrtare në hapësirën ku operacionet e Kombeve të Bashkuara janë duke u kryer;

b) **"Personel shoqërues"** nënkupton:

1. Personat e emëruar nga një Qeveri ose një organizatë ndërqeveritare me marrëveshje me organet kompetente të Kombeve të Bashkuara;

2. Personat e punësuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara ose nga një agjenci e specializuar ose nga Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike;

3. Personat e caktuar nga një organizatë joqeveritare humanitare ose agjenci sipas një marrëveshje me Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara ose me një agjenci të specializuar ose me Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike, për të kryer aktivitet në mbështetje të përmbushjes së mandatit të operacioneve të Kombeve të Bashkuara;

c) **"Operacione të Kombeve të Bashkuara"** nënkupton një operacion të vendosur nga organi kompetent të Kombeve të Bashkuara në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe të kryer nën autoritetin dhe kontrollin e Kombeve të Bashkuara;

(1) Kur operacioni kryhet për qëllimin e ruajtjes së rivendosjes të sigurisë dhe paqes ndërkombëtare; ose

(2) Kur Këshilli i Sigurimit ose Asambleja e Përgjithshme ka deklaruar, për qëllimin e kësaj Konvente, se ekziston një rrezik i veçantë për sigurimin e personelit pjesëmarrës në operacion;

(d) **"Shtet pritës"** nënkupton një shtet në territorin e të cilit kryhet operacioni i Kombeve të Bashkuara;

(e) **"Shtet tranzit"** nënkupton një shtet, përveç shtetit pritës, në territorin e të cilit personeli i Kombeve të Bashkuara dhe ai shoqërues ose pajisjet e tyre janë tranzit ose të pranishme përkohësisht në lidhje me një operacion të Kombeve të Bashkuara.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Kjo Konventë zbatohet në lidhje me personelin e Kombeve të Bashkuara dhe atë shoqërues dhe operacioneve të Kombeve të Bashkuara, siç përcaktohen në nenin 1.

2. Kjo Konventë nuk do të zbatohet në lidhje me një operacion të Kombeve të Bashkuara të autorizuar nga Këshilli i Sigurimit si një veprim detyrues në bazë të Kapitullit 7 të Kartës së Kombeve të Bashkuara në të cilin angazhohet ndonjë pjesëtar i personelit i cili është caktuar si luftëtar kundër forcave të armatosura e të organizuara dhe ndaj të cilëve zbatohet e drejta ndërkombëtare për konfliktet e armatosura

Neni 3
Identifikimi

1. Komponentët ushtarakë dhe policorë të operacioneve të Kombeve të Bashkuara dhe mjetet e tyre, anijet dhe avionët do të mbajnë shenja të dallueshme për identifikimin e tyre. Personeli, mjetet e tyre, anijet dhe avionët e tjerë të përfshirë në operacionet e Kombeve të Bashkuara do të jenë të identifikueshme në mënyrën e duhur derisa nuk është vendosur ndryshe nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

2. Gjithë personeli i Kombeve të Bashkuara dhe ai shoqërues do të mbajë dokumentet përkatëse të identifikimit.

Neni 4
Marrëveshjet mbi statusin e operacionit

Shteti pritës dhe Kombet e Bashkuara do të përfundojnë sa më shpejt që të jetë e mundur një

marrëveshje mbi statusin e operacionit të Kombeve të Bashkuara dhe të gjithë personelit të caktuar në operacion duke përfshirë, inter alia, dispozita mbi privilegjet dhe imunitetet për komponentët ushtarakë dhe policorë të operacionit.

Neni 5
Tranzit

Shteti tranzit do të lehtësojë kalimin tranzit të personelit të Kombeve të Bashkuara dhe atij shoqërues dhe të mjeteve të tyre për në dhe nga shteti pritës.

Neni 6
Respektimi i ligjeve dhe rregullave

1. Pa cënuar imunitetet dhe privilegjet që ata mund të gëzojnë ose për nevojat e detyrave të tyre, personeli i Kombeve të Bashkuara dhe ai shoqërues do të:

(a) Respektojë ligjet dhe rregullat e shtetit pritës dhe të shtetit tranzit; dhe

(b) Rezervohen nga ndonjë veprim ose aktivitet i papajtueshëm me paanshmërinë dhe natyrën ndërkombëtare të detyrimeve të tyre.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të marrë të gjitha masat e duhura për të siguruar zbatimin e këtyre detyrimeve.

Neni 7
Detyrimi i garantimit të sigurisë së personelit të Kombeve të Bashkuara dhe atij shoqërues

1. Personeli i Kombeve të bashkuara dhe ai shoqërues, mjetet dhe ambientet e tyre nuk do të jenë objekt sulmi ose i ndonjë veprimi që i pengon ata të përmbushin mandatin e tyre.

2. Shtetet palë do të marrin të gjitha masat e përshtatshme për garantimin e sigurisë së personelit të Kombeve të Bashkuara dhe atij shoqërues. Në veçanti, shtetet palë do të marrin të gjithë hapat e duhur për mbrojtjen e personelit të Kombeve të Bashkuara dhe atij shoqërues, të caktuar në territorin e tyre, nga krimet e përcaktuara në nenin 9.

3. Shtetet palë do të bashkëpunojnë me Kombet e Bashkuara dhe shtetet e tjera palë lidhur me zbatimin e kësaj Konvente, veçanërisht në ndonjë rast kur shteti pritës është i paaftë për të marrë masat e nevojshme.

Neni 8
Detyrimi për lirimin ose kthimin e personelit të Kombeve të Bashkuara dhe atij shoqërues të zënë rob ose të ndaluar

Me përjashtim të rasteve të një marrëveshjeje të zbatueshme për statusin e forcave, në qoftë se personeli i Kombeve të Bashkuara dhe ai shoqërues është zënë rob ose është ndaluar gjatë kohës së realizimit të detyrave të tyre dhe është kryer indentifikimi i tyre, ata nuk do të jenë subjekt hetimesh, do të lirohen menjëherë dhe do të kthehen në Kombet e Bashkuara ose tek autoritetet e tjera përkatëse. Në pritje të lirimit të tyre ky personel do të trajtohet në përputhje me standardet e njohura universale të të drejtave të njeriut dhe parimeve të Konventës së Gjenevës së 1949.

Neni 9
Krimet kundër personelit të Kombeve të Bashkuara dhe atij shoqërues

1. Kryerja me paramendim e:

(a) Vrasjes, rrëmbimit ose sulmeve të tjera ndaj personit ose lirisë se ndonjë prej personelit të

Kombeve të Bashkuara dhe atij shoqërues;

(b) Sulmit të dhunshëm ndaj ambienteve zyrtare, rezidencave private ose mjeteve të transportit të personelit të Kombeve të Bashkuara dhe atij shoqërues, të tilla që vënë në rrezik jetën e personit ose lirinë e tij;

(c) Kërcënimit për kryerjen e një sulmi të tillë me synim që të detyrojë një person fizik ose juridik të kryejë ose të mos kryejë një veprim;

(d) Përpjekjes për të kryer një sulm të tillë dhe;

(e) Veprimit që përbën pjesëmarrje si një autor në një sulm të tillë, ose në një përpjekje për kryerjen e këtij sulmi, ose në organizimin ose urdhërimin e të tjerëve të kryejnë sulme të tilla, do të cilësohen nga çdo shtet krime sipas së drejtës së tij kombëtare.

2. Çdo shtet palë do t'i konsiderojë krimet e përcaktuara në paragrafin 1 të dënueshme me dënime të përshtatshme, të cilat do të kenë parasysh natyrën e rëndë të tyre.

Neni 10

Vendosja e juridiksionit

1. Çdo shtet palë do të marrë masa të tilla që mund të jenë të domosdoshme për vendosjen e juridiksionit të tij mbi krimet e përcaktuara në nenin 9 në rastet e mëposhtme:

(a) Kur krimi është kryer në territorin e atij shteti ose në bordin e një anijeje ose avioni të regjistruar në atë shtet;

(b) Kur i pandehuri është shtetas i atij shteti.

2. Një shtet palë mundet, gjithashtu, të vendosë juridiksionin e tij mbi ndonjë krim të tillë kur ai është kryer:

(a) Nga një person pa shtetësi, vendbanimi i të cilit është në atë shtet; ose

(b) Ndaj një shtetasi të atij shteti; ose

(c) Në një përpjekje për të detyruar atë shtet të kryejë ose të heqë dorë nga kryerja e ndonjë veprimi.

3. Një shtet palë, i cili ka vendosur juridiksionin e tij siç përmendet në paragrafin 2, do të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Në qoftë se ky shtet palë heq dorë nga ky juridiksion, ai do të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

4. Çdo shtet palë do të marrë masa të tilla për sa mund të jetë e nevojshme për të vendosur juridiksionin e tij mbi krimet e përcaktuara në nenin 9, në rastet kur i pandehuri është i pranishëm në territorin e tij dhe ky shtet nuk e ekstradon këtë person në përputhje me nenin 15 në ndonjë nga shtetet palë që kanë vendosur juridiksionin e tyre sipas paragrafit 1 ose 2.

5. Kjo Konventë nuk përjashton ndonjë juridiksion penal për të ushtruar në përputhje me të drejtën kombëtare.

Neni 11

Parandalimi i krimeve kundër personelit të Kombeve të Bashkuara dhe atij shoqërues

Shtetet palë do të bashkëpunojnë për parandalimin e krimeve të përcaktuara në nenin 9, veçanërisht nëpërmjet:

(a) Duke marrë të gjitha masat e zbatueshme për parandalimin e përgatitjeve në territoret respektive të tyre për kryerjen e këtyre krimeve brenda ose jashtë territorit të tyre; dhe

(b) Duke shkëmbyer informacion në përputhje me ligjet e tyre kombëtare dhe duke koordinuar marrjen e masave administrative dhe masat e tjera të përshtatshme për parandalimin e kryerjes së këtyre krimeve.

Neni 12
Komunikimi i informacionit

1. Sipas kushteve të parashikuara për të në të drejtën kombëtare, shteti palë në territorin e të cilit është kryer një krim sipas përcaktimit në nenin 9 dhe nëse ka arsye të besojë se i pandehuri ka ikur nga territori i tij, do të komunikojë me Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara dhe, direkt ose nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm, me shtetin ose shtetet e interesuara të gjitha faktet e lidhura drejtpërdrejt përsa i përket kryerjes së krimeve dhe të gjithë informacionin e vlefshëm lidhur me identifikimin e të pandehurve.

2. Kurdo që një krim, sipas përcaktimit në nenin 9, të ketë qenë kryer, ndonjë shtet palë i cili ka informacion lidhur me viktimat dhe rrethanat e krimit do të përpiqet ta transmetojë këtë informacion, sipas kushteve të parashikuara për të në të drejtën kombëtare të tij, plotësisht dhe menjëherë te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara dhe te shteti ose shtetet e interesuara.

Neni 13
Masat për garantimin e procedimit ose të ekstradimit

1. Kur rrethanat e justifikojnë, shteti palë në territorin e të cilit ndodhet i pandehuri do të marrë masat e duhura sipas të drejtës së tij kombëtare për të siguruar praninë e atij personi për qëllimin e procedimit ose të ekstradimit.

2. Masat e marra në përputhje me paragrafin 1 do t'i njoftohen, në përputhje me të drejtën kombëtare dhe pa vonesë, Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, dhe ose direkt ose nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm:

(a) shteti ku është kryer krimi;

(b) shtetit ose shteteve, shtetas i të cilit është i pandehuri ose, kur ky person është pa shtetësi, shtetit në territorin e të cilit ky person ka vendbanimin;

(c) shtetit ose shteteve, shtetas i të cilit është viktima; dhe

(d) shtete të tjera të interesuara.

Neni 14
Procedimi i të pandehurve

Shteti palë, në territorin e të cilit është i pranishëm, në rast se nuk e ekstradon atë, do të paraqesë, pa përjashtime të çfarëdo lloji dhe pa vonesë çështjen para autoriteteve të tij kompetente, me synim gjykimin e tij nëpërmjet procedimit në përputhje me ligjet e këtij shteti. Këto autoritete do të marrin vendimin e tyre në të njëjtën mënyrë si dhe për çështjet e shkeljeve të zakonshme të një natyre të rëndë sipas ligjit të këtij shteti.

Neni 15
Ekstradimi i të pandehurve

1. Në masën që krimet e përcaktuara në nenin 9 nuk janë të ekstradueshme në ndonjë marrëveshje ekzistuese ekstradimi midis shteteve palë, ato do të konsiderohen për këtë qëllim si të tilla. Shtetet palë angazhohen të përfshijnë këto krime si vepra të ekstradueshme në çdo marrëveshje ekstradimi që do të përfundojnë ndërmjet tyre.

2. Në qoftë se një shtet palë që e konsideron ekstradimin të kushtëzuar me ekzistencën e një marrëveshjeje, merr një kërkesë për ekstradim nga një shtet tjetër palë me të cilin nuk ka një marrëveshje ekstradimi, ai mundet që sipas mundësisë së tij ta konsiderojë këtë Konventë si një bazë ligjore për ekstradim përsa i përket këtyre krimeve. Ekstradimi do të jetë subjekt i kushteve të parashikuara në ligjet e shtetit kërkues.

3. Shtetet palë të cilat nuk e konsiderojnë ekstradimin të kushtëzuar me ekzistencën e një

marrëveshjeje, do të njohin këto krime si vepra të ekstradueshme ndërmjet tyre dhe që i nënshtrohen kushteve të parashikuara në ligjet e shtetit kërkues.

4. Secili nga këto krime, për qëllimet e ekstradimit ndërmjet shteteve palë, do të trajtohet ashtu sikur të ishte kryer jo vetëm brenda vendit në të cilin ndodh, por gjithashtu brenda territorit të shteteve palë të cilët kanë vendosur juridiksionin e tyre në përputhje me paragrafin 1 ose 2 të nenit 10.

Neni 16
Asistencë reciproke në çështjet kriminale

1. Shtetet palë do t'i afrojnë njëri-tjetrit masën më të madhe të asistencës në lidhje me procedurat penale të fituara në lidhje me krimet e përcaktuara në nenin 9, duke përfshirë asistencën në marrjen e provave në dispozicion të tyre të nevojshme për procedimet. Ligji i shtetit kërkues do të zbatohet në të gjitha rastet.

2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk do të veprojnë lidhur me detyrimet për asistencë reciproke të parashikuar në ndonjë marrëveshje tjetër.

Neni 17
Trajtim i drejtë

1. Çdo personi, hetimi ose gjykimi i të cilit është duke u kryer lidhur me ndonjë nga krimet e përcaktuara në nenin 9, do t'i garantohet trajtim i drejtë, shqyrtim gjyqësor i drejtë dhe mbrojtje e plotë e të drejtave të tij në të gjitha shkallët e hetimit ose të gjykimit.

2. Çdo person i akuzuar do të ketë të drejtë:

(a) Të komunikojë pa vonesë me përfaqësuesin e përshtatshëm më të afërt të shtetit ose shteteve, shtetas i të cilit është ky person, ose të cilit i është dhënë e drejta të mbrojë të drejtat e këtij personi, ose në qoftë se ky person është pa shtetësi, shtetit i cili me kërkesën e personit pranon të mbrojë të drejtat e këtij personi; dhe

(b) Të vizitohet nga përfaqësuesi i atij shteti ose atyre shteteve.

Neni 18
Njoftimi i rezultatit të gjykimit

Shteti palë ku është gjykuar i pandehuri do të komunikojë rezultatin përfundimtar të gjykimit te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, i cili do t'ia transmetojë informacionin shteteve të tjera palë.

Neni 19
Shpërndarja

Shtetet palë angazhohen të shpërndajnë këtë Konventë sa më gjerë që të jetë e mundur dhe në veçanti të përfshijnë në studimet si dhe dispozitat e së drejtës ndërkombëtare humanitare, në programet e tyre të trajnimit ushtarak.

Neni 20
Dispozita për ruajtjen e të drejtave

Asgjë në këtë Konventë nuk do të ndikojë në:

(a) Zbatimin e së drejtës humanitare ndërkombëtare dhe të standardeve universale të njohura të të drejtave të njeriut, ashtu si parashikohen në instrumentet ndërkombëtare lidhur me mbrojtjen e operacioneve të Kombeve të Bashkuara dhe të personelit të Kombeve të Bashkuara dhe atij shoqërues, ose për përgjegjësinë e këtij personeli për respektimin e ligjeve dhe standardeve të tilla;

(b) Të drejtat dhe detyrimet e shteteve, të parashikuara në kartën e Kombeve të Bashkuara, lidhur me pëlqimin për hyrjen e personave në territorin e tyre;

(c) Detyrimin e personelit të Kombeve të Bashkuara dhe atij shoqërues për të vepruar në përputhje me kushtet e mandatit të operacioneve të Kombeve të Bashkuara;

(d) Të drejtën e shteteve të cilët vullnetarisht kontribuojnë me personel në operacionet e Kombeve të Bashkuara për të tërhequr personelin e tyre nga pjesëmarrja në operacione të tilla; ose

(e) Të drejtën për një kompensim të përshtatshëm të pagueshëm në rast të vdekjes, paaftësisë, dëmtimit dhe sëmundjeve për shkak të shërbimit paqeruajtës të personave që kontribuojnë vullnetarisht nga Shtetet në operacionet e Kombeve të Bashkuara.

Neni 21
E drejta e vetëmbrojtjes

Asgjë në këtë Konventë nuk do të jetë konceptuar si një cenim nga e drejta e veprimit në kushtet e vetëmbrojtjes.

Neni 22
Zgjidhja e mosmarrëveshjes

1. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet dy ose më shumë shteteve palë lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente e cila nuk është zgjidhur nëpërmjet bisedimeve, me kërkesën e njërit prej tyre, do t'i paraqitet arbitrazhit. Në qoftë se brenda gjashtë muajve nga data e kërkesës për arbitrazhin palët janë të paaftë të bien dakord për organizimin e arbitrazhit, çdonjëra nga palët mund ta paraqesë mosmarrëveshjen në gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, duke vepruar në përputhje me Statutin e Gjykatës.

2. Çdo shtet palë mundet që në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit ose miratimit të kësaj Konvente ose aderimit të deklarojë se ai nuk e konsideron veten të detyruar nga i gjithë ose një pjesë e paragrafit 1. Shtetet e tjera palë nuk do të jenë të detyruara nga paragrafi 1 ose pjesa përkatëse në lidhje me ndonjë shtet palë i cili ka bërë një rezervë të tillë.

3. Çdo shtet palë që ka bërë një rezervë në përputhje me paragrafin 2 mund që në çdo kohë të tërheqë rezervën nëpërmjet njoftimit të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 23
Takimet rishikuese

Me kërkesën e njërit ose më shumë shteteve palë, dhe në qoftë se miratohet nga shumica e shteteve palë, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të mbledhë një takim të shteteve palë për rishikimin e Konventës, dhe për çdo problem që lidhet me zbatimin e saj.

Neni 24
Nënshkrimi

Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim nga të gjithë shtetet, deri në 31 dhjetor 1995, në Selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork.

Neni 25
Ratifikimi, pranimi ose miratimi

Kjo Konventë është subjekt i ratifikimit, pranimit ose miratimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 26
Aderimi

Kjo Konventë do të jetë e hapur nga çdo shtet. Instrumenti i aderimit do të depozitohet në Sekretarinë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

Neni 27
Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi tridhjetë ditë pasi instrumenti i njëzetedytë i ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit të jetë depozituar në Sekretarinë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

2. Për çdo shtet ratifikues, pranues, aprovues ose aderues në Konventë pas depozitimit të instrumentit të njëzetedytë të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, Konventa do të hyjë në fuqi ditën e tridhjetë pas depozitimit nga ky shtet të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

Neni 28
Denoncimi

1. Çdo shtet palë mund të denoncojë këtë Konventë me anë të njoftimit të shkruar të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

2. Denoncimi do të veprojë një vit pas datës në të cilën është marrë njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Neni 29
Tekstet autentike

Origjinali i kësaj Konvente, tekstet e të cilës në gjuhët arabe, kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle janë njëlloj autentike, do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara , e cila do t'i dërgojë kopje të vërtetuar të gjithë shteteve.

L I G J
Nr. 8597, datë 6.4.2000

PËR RATIFIKIMIN E "KONVENTËS PËR SHMANGIEN E TATIMEVE TË DYFISHTA, PËR TATIMET MBI TË ARDHURAT DHE KAPITALIN, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KONFEDERATËS ZVICERANE"

Në mbështetje të neneve 78,83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Konventa për shmangien e tatimeve të dyfishta, për tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicerane.”

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2604, datë 19.4.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

K O N V E N T Ë

NDËRMJET REPUBLIKËS SE SHQIPËRISË
dhe
KONFEDERATËS ZVICERANE
PËR ELEMINIMIN E TATIMEVE TË DYFISHTA LIDHUR
ME TATIMET MBI TË ARDHURAT DHE MBI KAPITALIN
QEVERIA E REPUBLIKËS SE SHQIPËRISË DHE KËSHILLI FEDERAL ZVICERAN

DUKE DËSHIRUAR, me qëllim zhvillimin e mëtejshëm dhe lehtësimin e marrëdhënieve ekonomike, të përfundojnë një Konventë për shmangien e tatimeve të dyfishta lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin,

KANË RËNË dakord për sa vijon:

Neni 1
Fushëveprimi i Konventës

Kjo Konventë do të zbatohet ndaj personave që janë rezidentë të njërit ose e të dy Shteteve Kontraktuese.

Neni 2
Tatimet që mbulon Konventa

1. Kjo Konventë do të zbatohet për tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin që zbatohen në emër të një Shteti Kontraktues, nënndarjeve të tij politike ose autoriteteve lokale, pavarësisht nga mënyra e vjeljes së tyre.

2. Do të konsiderohen tatime mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin të gjitha tatimet e vendosura mbi të ardhurat total, mbi kapitalin në total, ose mbi elemente të të ardhurave ose të kapitalit, përfshirë tatimet mbi fitimet nga shitblerja e pasurive të luajtshme ose të paluajtshme, tatimet mbi shumat totale të pagave të paguara nga sipërmarrjet, si edhe tatimet mbi rivlerësimin e kapitalit.

3. Tatimet ekzistuese ndaj të cilave do të zbatohet Konventa janë në veçanti:

a) Në Shqipëri:

(i) tatimet mbi fitimet e personave juridikë;

(ii) tatimet mbi aktivitetet e biznesit të vogël;

(iii) tatimet mbi të ardhurat personale;

(në vijim do t'i referohemi si "Tatimet Shqiptare").

b) Në Zvicër:

tatimet federale, kantonale dhe komunale

(i) mbi të ardhurat (të ardhurat në total, të ardhurat e fituara, të ardhurat nga kapitali, fitimet industriale dhe tregtare, fitimet nga tjetërsimi i kapitalit, dhe të tjera lloje të ardhurash), dhe

(ii) mbi kapitalin (pasuria totale, pasuria e luajtshme dhe e paluajtshme, aktivet tregtare, kapitali i paguar dhe rezervat, dhe lloje të tjera të kapitalit);

(në vijim do t'i referohemi si "Tatimet Zvicerane").

4. Konventa do të zbatohet gjithashtu për tatime të njëllojta ose tepër të ngjashme të cilat do të vendosen pas datës së nënëshkrimit të Konventës si shtojcë ose në vend të tatimeve ekzistuese. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do njoftojnë njëri-tjetrin për çdo ndryshim thelbësor që do të bëhet në ligjet përkatëse tatimore.

5. Konventa nuk do të zbatohet ndaj tatimeve të vjelura në burim mbi të ardhurat nga fitimi i një llotarije.

Neni 3

Përcaktime të përgjithshme

1. Për qëllimet e kësaj Konvente, përderisa përmbajtja të mos e kërkojë ndryshe:

a) termi "Shqipëria" nënkupton Republikën e Shqipërisë dhe kur përdoret në sensin gjeografik nënkupton territorin e Republikës së Shqipërisë, përfshirë çdo zonë tej ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë e cila, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe me ligjet e Republikës së Shqipërisë, është një zonë brenda së cilës Republika e Shqipërisë mund të ushtrojë të drejta lidhur me tabanin detar, nëntokën dhe burimet e tyre natyrore;

b) termi "Zvicra" nënkupton Konfederatën Zvicerane;

c) termat "një Shtet Kontraktues" dhe "Shteti tjetër Kontraktues" nënkuptojnë Shqipërinë ose Zvicrën siç e kërkon përmbajtja;

d) termi "person" përfshin një individ, një shoqëri dhe çdo grup tjetër personash;

e) termi "shoqëri" nënkupton çdo organ korporativ ose çdo person ligjor që trajtohet si person juridik për qëllime tatimore;

f) termat "sipërmarrje e një Shteti Kontraktues" dhe "sipërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues" nënkuptojnë respektivisht një sipërmarrje të ushtruar nga një rezident i një Shteti Kontraktues dhe një sipërmarrje të ushtruar nga një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues;

g) termi "trafik ndërkombëtar" nënkupton çdo transport me anije ose mjet fluturues që kryhet nga një sipërmarrje që ka vendin e saj të drejtimit efektiv në një Shtet Kontraktues, përveç kur anija ose avioni vepron vetëm midis vendeve të ndodhura në Shtetin tjetër Kontraktues;

h) termi "autoritet kompetent" nënkupton:

(i) në rastin e Shqipërisë, Ministrin e Financave ose përfaqsuesin e autorizuar prej tij;

(ii) në rastin e Zvicrës, Drejtorin e Administratës Federale të Tatimeve ose përfaqsuesin e autorizuar prej tij;

i) termi "nënështetas" nënkupton:

(i) çdo individ që zotëron nënshtetësinë e një Shteti Kontraktues;

(ii) çdo person juridik, ortakëri ose shoqëri që gëzon statusin si e tillë në përputhje me ligjet në fuqi në një Shtet Kontraktues.

2. Përsa i përket zbatimit të Konvenetës nga një Shtet Kontraktues, çdo term i pa përcaktuar këtu, përderisa përmbajtja të mos e kërkojë ndryshe, do të ketë kuptimin që i është dhënë sipas legjislacionit të atij Shteti lidhur me tatimet ndaj të cilave zbatohet Konventa.

Neni 4

Rezidenti

1. Për qëllime të kësaj Konvente, termi "rezident i një Shteti Kontraktues" nënkupton çdo person që, sipas ligjeve të atij Shteti, është subjekt i tatimeve atje për shkak të vendbanimit, rezidencës, vendit të drejtimit apo çdo kriteri tjetër të një natyre të ngjashme. Por ky term nuk përfshin personat që i nënshtrohen tatimit në atë Shtet vetëm për të ardhurat e realizuara në këtë Shtet apo kapitalin e vendosur aty.

2. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1 një individ është rezident i të dy Shteteve Kontraktuese atëhere statusi i tij do të përcaktohet si vijon:

a) ai do të konsiderohet rezident i Shtetit në të cilin ai ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij; në qoftë se ai ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij në të dy Shtetet, ai do të konsiderohet rezident i Shtetit me të cilin interesat e tij personale dhe ekonomike janë të lidhura më ngushtë (qendra e interesave jetike);

b) në qoftë se Shteti në të cilin ai ka qendrën e interesave jetike nuk mund të përcaktohet, ose në qoftë se ai nuk ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij në asnjërin Shtet, ai do të konsiderohet rezident i Shtetit Kontraktues në të cilin ai qëndron zakonisht;

c) në qoftë se ai qëndron rregullisht në të dy Shtetet ose në asnjërin prej tyre, ai do të konsiderohet rezident i Shtetit nënshtetas i të cilit ai është;

d) në qoftë se ai është nënshtetas i të dy Shteteve ose i asnjërit prej tyre, autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do ta zgjidhin çështjen me mirëkuptim reciprok.

3. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1 një person juridik është rezident i të dy Shteteve Kontraktuese, atëhere ai do të konsiderohet rezident i Shtetit në të cilin është vendosur qendra e tij e drejtimit efektiv.

Neni 5

Seli (Përfaqësi) e përhershme

1. Për qëllime të kësaj Konvente termi "seli (përfaqësi) e përhershme" nënkupton një vend fiks biznesi nëpërmjet të cilit ushtrohet tërësisht ose pjesërisht aktiviteti i sipërmarrjes.

2. Termi "seli e përhershme" përfshin në veçanti:

a) një vend drejtimi;

b) një degë;

c) një zyrë;

d) një fabrikë;

e) një punishte, dhe

f) një minierë, një pus nafte ose gazi, gurore, ose çdo vend tjetër për shfrytëzimin e burimeve natyrore.

3. Një shesh ndërtimi apo montimi, ose projekt instalimi përbën një seli të përhershme vetëm nëse zgjat më tepër se nëntë muaj.

4. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij neni termi "seli e përhershme" nuk do të përfshijë:

a) përdorimin e pajisjeve apo objekteve vetëm për qëllime magazinimi, ekspozimi ose të shpërndarjes së mallrave që i përkasin sipërmarrjes;

b) mbajtjen e një gjendjeje mallrash që i përkasin sipërmarrjes vetëm për qëllime magazinimi, ekspozimi apo shpërndarjeje;

c) mbajtjen e një gjendjeje mallrash që i përkasin sipërmarrjes vetëm për qëllime përpunimi nga një sipërmarrje tjetër;

d) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm me qëllim blerjen e mallrave ose për mbledhje informacioni, për sipërmarrjen;

e) mbajtja e një vendi fiks biznesi vetëm për qëllim reklame, për dhënie informacioni, për kërkime shkencore apo për aktivitete të ngjashme që kanë karakter përgatitor ose ndihmës për sipërmarrjen;

f) një projekt instalimi i ushtruar nga një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues në Shtetin tjetër Kontraktues lidhur me shpërndarjen e makinerive ose pajisjeve të prodhuara nga ajo sipërmarrje;

g) mbajtja e një vendi fiks biznesi vetëm për çdo kombinim të aktiviteteve të përmendura në nënparagrafët a) deri f), me kusht që i tërë aktiviteti i vendit fiks të biznesit që rezulton nga ky kombinim të jetë i një karakteri përgatitor ose ndihmës.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, kur një person i ndryshëm nga një agjent me status të pavarur ndaj të cilit aplikohet paragrafi 6, vepron në emër të një sipërmarrjeje dhe ka, e zakonisht

ushtron, në një Shtet Kontraktues një autoritet për të përfunduar kontrata në emër të sipërmarrjes, kjo sipërmarrje do të konsiderohet se ka një seli të përhershme në atë Shtet lidhur me çdo aktivitet që ai person ndërmerr për sipërmarrjen, përveç kur aktivitetet e këtij personi kufizohen në ato të përmendura në paragrafin 4 të cilat, edhe pse ushtrohen nëpërmjet një vendi fiks biznesi, nuk e bëjnë këtë vend fiks biznesi një seli të përhershme në bazë të dispozitave të atij paragrafi.

6. Një sipërmarrje nuk do të konsiderohet se ka një seli të përhershme në një Shtet Kontraktues vetëm për faktin se ajo ushtron biznes në atë shtet nëpërmjet një ndërmjetësi, agjenti komisioner të përgjithshëm ose çdo agjenti tjetër me status të pavarur, me kusht që këta persona të veprojnë në kuadrin e zakonshëm të aktivitetit të tyre.

7. Fakti që një shoqëri që është rezidente e një Shteti Kontraktues kontrollon ose kontrollohet nga një shoqëri që është rezidente e Shtetit tjetër Kontraktues, ose që ushtron biznes në atë Shtet tjetër (nëpërmjet një selije të përhershme ose në forma të tjera) nuk përbën në vetvete arsye të mjaftueshme për të konsideruar njërën shoqëri seli të përhershme të tjetrës.

Neni 6

Të ardhurat nga pasuria e paluajtshme

1. Të ardhurat e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga pasuria e paluajtshme (përfshirë të ardhurat nga bujqësia dhe pyjet) të vendosura në Shtetin tjetër Kontraktues mund të tatohen në këtë Shtet tjetër.

2. Termi "pasuri e paluajtshme" do të ketë kuptimin që ka sipas ligjit të Shtetit Kontraktues ku është vendosur prona në fjalë. Në çdo rast ky term do të përfshijë pasuritë aksesore të pasurisë së paluajtshme, inventarin e gjallë dhe pajisjet e përdorura në bujqësi e në pyje, të drejtat ndaj të cilave zbatohen dispozitat e legjislacionit të përgjithshëm lidhur me pronën mbi tokën, uzufrukti i pasurive të paluajtshme dhe të drejtat ndaj pagesave fikse ose variabël për shfrytëzimin ose të drejtën për të shfrytëzuar vendburimet minerare dhe burime e pasuri të tjera natyrore; anijet dhe avionët nuk do të konsiderohen pasuri të paluajtshme.

3. Dispozitat e paragrafit 1 do të zbatohen ndaj të ardhurave të realizuara nga përdorimi direkt, dhënia me qira, ose përdorimi në çdo formë tjetër i pasurive të paluajtshme.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 3 do të zbatohen gjithashtu ndaj të ardhurave nga pasuria e paluajtshme e një sipërmarrjeje dhe ndaj të ardhurave nga pasuria e paluajtshme e përdorur për kryerjen e shërbimeve personale të pavarura.

Neni 7

Fitimet nga biznesi i sipërmarrjeve

1. Fitimet e një sipërmarrjeje të një Shteti Kontraktues do të tatohen vetëm në atë Shtet përveç, kur sipërmarrja ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selije të përhershme të vendosur atje. Në qoftë se sipërmarrja ushtron aktivitetin në mënyrën e sipërpërmendur, fitimet e sipërmarrjes mund të tatohen në Shtetin tjetër por vetëm ajo pjesë e tyre që i atribuohet asaj selije të përhershme.

2. Pa cënuar dispozitat e paragrafit 3, kur një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selije të përhershme të vendosur aty, atëhere në secilin Shtet Kontraktues selisë së përhershme do t'i atribuohen fitimet që ajo do të realizonte sikur ajo të ishte një sipërmarrje e veçantë dhe e pavarur që do të vepronte në të njëjtin aktivitet ose në aktivitete të ngjashme nën kondita të njëjta ose të ngjashme, tërësisht e pavarur nga sipërmarrja seli e përhershme e së cilës ajo është.

3. Në përcaktimin e fitimeve të një selije të përhershme, do të lejohet reduktimi i shpenzimeve që janë kryer për qëllimet e selisë së përhershme, përfshirë shpenzimet e përgjithshme administrative dhe ekzekutive të kryera si në Shtetin ku ndodhet selia e përhershme ashtu edhe gjetkë.

4. Kur në një Shtet Kontraktues përcaktimi i fitimeve që do t’i atribuohen një selije të përhershme

zakonisht bëhet në bazë të ndarjes të fitimeve totale të sipërmarrjes midis pjesëve të veçanta të saj, dispozitat e paragrafit 2 nuk e pengojnë atë Shtet Kontraktues për përcaktimin e fitimeve që do të tatohen në bazë të një metode të tillë; megjithatë, metoda e ndarjes së fitimeve duhet të jetë e tillë që rezultati të jetë në përputhje me parimet që dalin nga ky nen.

5. Asnjë fitim nuk do t'i atribuohet një selije të përhershme vetëm për faktin se ajo blen mallra për sipërmarrjen.

6. Për qëllime të paragrafëve të mëparshëm, fitimet që i atribuohen një selije të përhershme do të përcaktohen me të njëjtën metodë çdo vit përderisa nuk ka arësye të drejta dhe të mjaftueshme për të vepruar ndryshe.

7. Kur fitimet përmbajnë elemente të të ardhurave që trajtohen veçmas në nene të tjera të kësaj Konvente, atëhere dispozitat e atyre neneve nuk do të ndikohen nga dispozitat e këtij neni.

Neni 8
Transporti detar dhe ajror

1. Fitimet nga veprimtaria e anijeve ose avionëve në trafikun ndërkombëtar do të tatohen vetëm në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet qendra e drejtimit efektiv të sipërmarrjes.

2. Në qoftë se vendi i drejtimit efektiv të një sipërmarrjeje të transportit detar është mbi bordin e një anijeje, atëhere ajo do të konsiderohet e vendosur në Shtetin Kontraktues ku ndodhet porti ku qëndron anija, ose, në mungesë të një porti të tillë, në Shtetin Kontraktues rezident i të cilit është përdoruesi i anijes.

3. Dispozitat e paragrafit 1 do të zbatohen gjithashtu ndaj fitimeve nga pjesëmarrja në një marrëveshje, një biznes të përbashkët apo në një agjenci ndërkombëtare transporti.

Neni 9
Sipërmarrje të lidhura

1. Kur:

a) një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues merr pjesë direkt ose indirekt në drejtimin, kontrollin apo kapitalin e një sipërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues, ose

b) të njëjtët persona marrin pjesë direkt ose indirekt në drejtimin, kontrollin apo kapitalin e një sipërmarrjeje të një Shteti Kontraktues dhe të një sipërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues, dhe në secilin rast kushtet që janë pranuar ose që janë diktuar midis dy sipërmarrjeve në marrëdhëniet e tyre tregtare apo financiare ndryshojnë nga ato që do të vendoseshin midis sipërmarrjeve të pavarura, atëhere çdo fitim që do të realizohej nga njëra sipërmarrje, por që për shkak të lidhjeve të veçanta të përmendura në fillim nuk është realizuar, mund të përfshihet në fitimet e asaj sipërmarrjeje dhe të tatohet normalisht.

2. Kur fitimet për të cilat një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues është ngarkuar me tatim në atë Shtet janë përfshirë gjithashtu në fitimet e një sipërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues dhe janë tatuar normalisht, dhe fitimet e përfshira në këtë mënyrë janë fitime që do të realizoheshin nga sipërmarrja e këtij Shteti tjetër Kontraktues, nëse kushtet e vendosura midis sipërmarrjeve, do të ishin ato që do të vendoseshin midis sipërmarrjeve të pavarura, atëhere autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese mund të konsultohen me njëri tjetrin me qëllim arritjen e një marrëveshjeje mbi rregullimin e fitimeve në të dy Shtetet Kontraktuese.

3. Një Shtet Kontraktues do të ndryshojë fitimet e një sipërmarrje në rrethanat që i referohen paragrafit 1 para mbarimit të afatit limit të përcaktuar në legjislacionin e tij të brendshëm, dhe, në çdo rast, jo më vonë se pas pesë vitesh nga përfundimi i vitit në të cilin fitimet që janë subjekt i një ndryshimi të tillë janë realizuar nga një sipërmarrje e atij Shteti. Ky paragraf nuk do të zbatohet në rast mashtrimesh apo mosplotësime me paramendim të detyrimeve.

Neni 10
Dividentët

1. Dividentët e paguar nga një kompani që është rezidente e një Shteti Kontraktues një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohen në këtë Shtet tjetër.

2. Megjithatë, këta dividentë mund të tatohen gjithashtu në Shtetin Kontraktues rezidente e të cilit është kompania paguese e dividentëve dhe në përputhje me ligjet e atij Shteti, por nëse marrësi është pronari përfitues i dividentëve, tatimi i ngarkuar nuk do të kalojë:

a) 5 përqind të shumës bruto të dividentëve nëse pronari përfitues është një shoqëri (jo ortakëri) që zotëron direkt të paktën 25 përqind të kapitalit të kompanisë paguese të dividentëve;

b) 15 përqind të shumës bruto të dividentëve në të gjitha rastet e tjera.

Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të vendosin me mirëkuptim reciprok mënyrën e zbatimit të këtyre kufizimeve.

Ky paragraf nuk do të ketë efekt mbi tatimin e kompanisë lidhur me fitimet nga të cilat janë paguar dividentët.

3. Në funksion të këtij Neni, termi "dividentë" nënkupton të ardhurat nga aksionet e çdo lloji, aksione të themelimit, aksione minerare ose të drejta të tjera, që nuk janë kërkesa borxhi, pjesëmarrja në fitime, si edhe të ardhurat nga të drejta të tjera korporative që i nënshtrohen të njëjtit trajtim tatimor si të ardhurat nga aksionet, nga ligjet e Shtetit rezidente e të cilit është kompania që bën shpërndarjen e divideneve.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen nëse pronari përfitues i dividentëve, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron aktivitet në Shtetin tjetër Kontraktues rezidente e të cilit është kompania paguese e divideneve, nëpërmjet një selije të përhershme të vendosur aty, ose kryen në atë Shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur aty, dhe zotërimi lidhur me të cilin janë paguar dividentët është efektivisht i lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në një rast të tillë do të zbatohen, dispozitat e Nenit 7 ose Nenit 14, si të paraqitet rasti.

5. Kur një kompani që është rezidente e një Shteti Kontraktues realizon fitime ose të ardhura nga Shteti tjetër Kontraktues, ky Shtet tjetër mund të mos zbatojë tatim mbi dividentet e paguar nga kompania, përveç kur këto dividentë i paguhen një rezidenti të Shtetit tjetër ose kur zotërimi lidhur me të cilin janë paguar dividentët është efektivisht i lidhur me një seli të përhershme ose bazë fikse të vendosur në këtë Shtet tjetër; subjekt i tatimit mbi fitimet e pashpërndara nuk janë gjithashtu as fitimet e pashpërndara të kompanisë, edhe sikur dividentët e paguar ose fitimet e pashpërndara konsistojnë tërësisht ose pjesërisht si fitime apo të ardhura të realizuara në këtë Shtet tjetër.

Neni 11
Interesat

1. Interesat që krijohen në një Shtet Kontraktues dhe i paguhen një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohen në këtë Shtet tjetër.

2. Megjithatë, këto interesa mund të tatohen edhe në Shtetin Kontraktues ku ato krijohen dhe në përputhje me ligjet e këtij Shteti, por kur marrësi është pronari përfitues i interesave dhe tatimi i zbatuar nuk duhet të kalojë 5 përqind të shumës bruto të interesit. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese me mirëkuptim reciprok do të vendosin mënyrën e aplikimit të këtij kufizimi.

3. Termi "interesa" në kuptimin e përdorur në këtë Nen nënkupton të ardhurat nga kërkesat e borxhit të çdo lloji, të siguruara ose jo me hipotekim ndaj pasurive dhe që e kanë ose jo të drejtën e pjesmarrjes në fitimet e debitorit, dhe në veçanti, të ardhurat nga letrat me vlerë të emetuara nga Shteti, të ardhurat nga obligacionet, përfshirë fitimet nga shitblerja e këtyre letrave me vlerë dhe obligacioneve. Gjobat e ngarkuara për pagesa të vonuara nuk do të konsiderohen si interesa për qëllime të këtij neni.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen në qoftë se pronari përfitues i interesave,

duke qenë një rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues në të cilin krijohen (lindin) interesat, nëpërmjet një selije të përhershme të vendosur aty, ose kryen në këtë Shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur aty, dhe kërkesa e huasë lidhur me të cilën paguhet interesi është efektivisht e lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose 14, si të paraqitet rasti.

5. Interesat do të konsiderohen se krijohen në një Shtet Kontraktues kur paguesi është vetë ai Shtet, një nënndarje politike, një autoritet lokal ose një rezident i atij Shteti. Megjithatë, kur personi që paguan interesat, qoftë ose jo rezident i njërit Shtet Kontraktues, ka në njërin Shtet Kontraktues një seli të përhershme ose një bazë fikse në lidhje me të cilën ka lindur huaja për të cilën paguhet interesi, dhe këto interesa krijohen nga kjo seli e përhershme ose bazë fikse, atëhere këto interesa do të konsiderohen se janë krijuar në Shtetin ku është vendosur selia e përhershme ose baza fikse.

6. Kur për shkak të marrëdhënieve të veçanta midis paguesit dhe pronarit përfitues të interesave ose midis të dyve dhe personave të tretë, shuma e interesave, bazuar në huanë për të cilën paguhen, e kalon shumën mbi të cilën duhej të ishte rënë dakord midis paguesit dhe pronarit përfitues në mungesë të marrëdhënieve të tilla, dispozitat e këtij neni do të zbatohen vetëm mbi shumën e përmendur në fund. Në këtë rast, pjesa që kalon pagesën normale do të mbetet e tatueshme në përputhje me ligjet e secilit Shtet, duke patur parasysh edhe dispozitat e tjera të kësaj Konvente.

Neni 12
Të ardhurat nga e drejta e autorit (honoraret)

1. Të ardhurat nga e drejta e autorit (honoraret) që krijohen në një Shtet Kontraktues dhe i paguhen një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohen në këtë Shtet tjetër.

2. Megjithatë, honoraret e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, mund të tatohen gjithashtu në Shtetin Kontraktues ku krijohen dhe në përputhje me ligjet e këtij Shteti, por tatimi i ngarkuar nuk duhet të kaloje 5 përqind të shumës bruto të honorarit. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të vendosin me mirëkuptim reciprok mënyrën e aplikimit të këtij kufizimi.

3. Termi "Honorare", siç është përdorur në këtë nen, nënkupton pagesat e çdo lloji të marra si shpërblim për përdorimin ose të drejtën e përdorimit të çdo të drejte të autorit për punimet letrare, artistike ose shkencore, përfshirë filmat kinematografikë, çdo patentë, markë tregtare, skicë ose model, plan, proces ose formulë sekrete, apo për informacione lidhur me eksperiencën industriale tregtare apo shkencore.

4. Dispozitat e paragrafeve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen nëse pronari përfitues i honorareve, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues ku krijohen honoraret, nëpërmjet një selije të përhershme të vendosur aty, ose kryen në atë Shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse të vendosur aty, dhe e drejta ose prona lidhur me të cilën paguhen honoraret është efektivisht e lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 14, si të paraqitet rasti.

5. Honoraret do të konsiderohet se krijohen në një Shtet Kontraktues kur pagues është vetë ai Shtet, një nënndarje politike, një autoritet lokal ose një rezident i atij Shteti. Megjithatë, kur personi që paguan honoraret, qoftë ose jo rezident i një Shteti Kontraktues, ka në njërin Shtet Kontraktues një seli të përhershme ose një bazë fikse në lidhje me të cilën ka lindur e drejta e pagimit të honorareve, dhe këto honorare kanë lindur nga kjo seli e përhershme ose bazë fikse, atëherë këto honorare konsiderohen se kanë lindur në Shtetin Kontraktues ku është vendosur selija e përhershme ose baza fikse.

6. Kur për shkak të lidhjeve të veçanta midis paguesit dhe pronarit përfitues ose midis të dyve dhe personave të tretë, shuma e honorareve, duke patur parasysh përdorimin, të drejtën apo informacionin për të cilin ato janë paguar, e kalon shumën për të cilën do të ishte rënë dakord midis paguesit dhe pronarit përfitues në mungesë të marrëdhënieve të tilla, atëhere dispozitat e këtij neni do të zbatohen vetëm mbi shumën e përmendur në fund. Në një rast të tillë shuma e shpërblimit që kalon shpërblimin normal do të mbetet e tatueshme sipas ligjeve përkatëse të sejcilit Shtet Kontraktues, duke patur parasysh dispozitat e tjera të kësaj Konvente.

Neni 13
Fitimet nga tjetërsimi i kapitalit

1. Fitimet e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga tjetërsimi i pasurive të paluajtshme që i referohen nenit 6 dhe të vendosura në Shtetin tjetër Kontraktues mund të tatohen në këtë Shtet tjetër.

2. Fitimet nga tjetërsimi i pasurive të luajtshme që bëjnë pjesë në pasuritë e biznesit të një selije të përhershme që një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues ose nga pasuritë e luajtshme që i përkasin një baze fikse në dispozicion të një rezidenti të një Shteti Kontraktues në Shtetin tjetër Kontraktues për kryerjen e shërbimeve personale të pavarura, përfshirë edhe fitimet nga tjetërsimi i kësaj selije të përhershme (vetëm ose bashkë me sipërmarrjen) ose i kësaj baze fikse, mund të tatohen në këtë Shtet tjetër.

3. Fitimet e realizuara nga tjetërsimi i anijeve ose avionëve që veprojnë në trafikun ndërkombëtar ose i pasurive të luajtshme që i përkasin veprimtarisë së këtyre anijeve apo avionëve do të tatohen vetëm në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet vendi i drejtimit efektiv të sipërmarrjes.

4. Fitimet nga tjetërsimi i çdo pasurie që nuk mbulohet nga paragrafët 1, 2 dhe 3 do të tatohen vetëm në Shtetin Kontraktues, rezident i të cilit është tjetërsuesi.

Neni 14
Shërbimet personale të pavarura

1. Të ardhurat e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues, lidhur me shërbimet profesionale ose aktivitete të tjera të një karakteri të pavarur, do të tatohen vetëm në atë Shtet, përveç kur ai ka një bazë fikse në dispozicion të tij në Shtetin tjetër Kontraktues për kryerjen e aktiviteteve të tij. Nëse ai ka një bazë të tillë fikse, të ardhurat mund të tatohen në Shtetin tjetër, por vetëm ajo pjesë e tyre që i atrubuohet asaj baze fikse.

2. Termi "shërbime profesionale" përfshin në veçanti aktivitetet e pavarura shkencore, letrare, artistike, arsimore apo mësimdhënieje, si dhe aktivitetet e pavarura të mjekëve, avokatëve, inxhinierëve, arkitektëve, dentistëve dhe llogaritarëve.

Neni 15
Shërbimet personale te varura

1. Në bazë të dispozitave të neneve 16, 18 dhe 19, pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme që përfitohen nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga punësimi i tij do të tatohen vetëm në atë Shtet, përveç kur puna është ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues. Nëse puna ushtrohet në këtë mënyrë, atëherë këto të ardhura mund të tatohen në këtë Shtet tjetër.

2. Përjashtuar dispozitat e paragrafit 1, shpërblimet e përfituara nga një rezident i një Shteti Kontraktues, lidhur me punën e ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues, do të tatohen vetëm në Shtetin e përmendur në fillim, në qoftë se:

a) përfituesi është prezent në Shtetin tjetër për një periudhë ose periudha që nuk i kalojnë në total 183 ditë në vitin fiskal përkatës, dhe

b) shpërblimi paguhet nga, ose në emër të, një punëdhënësi që nuk është rezident i Shtetit tjetër, dhe

c) shpërblimi nuk ka lindur nga një seli e përhershme ose bazë fikse që punëdhënësi ka në Shtetin tjetër.

3. Përjashtuar dispozitat e mëparshme të këtij neni, shpërblimet e realizuara lidhur me punën e ushtruar në bordin e një anije ose avioni që ushtron aktivitet në trafikun ndërkombëtar mund të tatohen në Shtetin Kontraktues në të cilin është vendosur vendi i drejtimit efektiv të sipërmarrjes.

Neni 16
Shpërblimet e drejtorëve

Shpërblimet e drejtorëve dhe pagesa të tjera të ngjashme të realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues në pozitën e tij si anëtar i bordit të drejtorëve ose çdo organi të ngjashëm të një shoqërie që është rezidente e Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohen në këtë Shtet tjetër.

Neni 17
Artistët dhe sportistët

1. Pavarësisht nga dispozitat e Neneve 14 dhe 15, të ardhurat e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues si një artist theatri, kinematografie, radio-televizioni, muzikant, apo një sportist, nga aktivitetet e tij personale si të tillë të ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen në këtë Shtet tjetër.

2. Kur të ardhurat lidhur me aktivitetet personale të ushtruara nga një artist ose sportist në pozitën e tij si i tillë realizohen jo direkt nga sportisti apo artisti por nga një person tjetër, këto të ardhura, pavarësisht nga dispozitat e neneve 7, 14 dhe 15, mund të tatohen në Shtetin Kontraktues në të cilin janë ushtruar aktivitetet e artistit apo sportistit. Ky paragraf nuk do të zbatohet nëse vetë artisti ose sportisti, apo persona të lidhur me të nuk marrin pjesë direkt në fitimet e realizuara nga një person i tillë.

3. Paragrafët 1 dhe 2 nuk do të zbatohen ndaj të ardhurave nga aktivitetet e ushtruara nga artistët ose sportistët, nëse këto të ardhura rrjedhin direkt ose indirekt kryesisht nga fonde publike.

Neni 18
Pensionet

Pa cënuar dispozitat e paragrafit 2 të nenit 19, pensionet dhe shpërblime të tjera të ngjashme, paguar një rezidenti të një Shteti Kontraktues lidhur me punësimin e tij në të kaluarën, do të tatohen vetëm në atë Shtet.

Neni 19
Shërbimet qeveritare

1. a) Shpërblimet, të ndryshme nga pensionet, paguar nga një Shtet Kontraktues, nga një nënndarje politike apo një autoritet lokal atje një individi lidhur me shërbimet e kryera atij Shteti, nënndarja apo autoriteti do të tatohen vetëm në atë Shtet.

b) Megjithatë, këto shpërblime do të tatohen vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues, nëse shërbimet janë kryer në atë Shtet dhe individi është rezident i atij Shteti, i cili:

(i) është nënështetas i atij Shteti, ose

(ii) nuk është bërë rezident i atij Shteti vetëm për qëllim të kryerjes së shërbimit.

2. a) Çdo pension i paguar nga, apo prej fondeve të krijuara, nga një Shtet Kontraktues, një nënndarje politike apo një autoritet lokal atje një individi lidhur me shërbimet e kryera atij Shteti, nënndarja apo autoriteti do të tatohet vetëm në atë Shtet.

b) Megjithatë, këto pensione do të tatohen vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues nëse individi është një rezident dhe një nënështetas i atij Shteti.

3. Dispozitat e neneve 15, 16 dhe 18 do të zbatohen mbi shpërblimet dhe pensionet lidhur me shërbimet e kryera në lidhje me një aktivitet biznesi të ushtruar nga një Shtet Kontraktues, nënndarje politike apo autoritet lokal atje.

Neni 20
Studentët dhe specializantët

Pagesat që një student apo specializant, i cili është ose ishte menjëherë para vajtjes në një Shtet Kontraktues një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues dhe që ndodhet në Shtetin e përmendur në fillim vetëm për qëllim arsimimi apo specializimi, përfiton për qëllim të mbajtjes së tij, arsimimit apo specializimit, nuk do të tatohen në atë Shtet, me kusht që të tilla pagesa të kryhen nga burime jashtë atij Shteti.

Neni 21
Të ardhura të tjera

1. Lloje të ardhurash të një rezidenti të një Shteti Kontraktues, kudo që të krijohen, që nuk lidhen me artikujt e mëparshëm të kësaj Konvente, do të tatohen vetëm në atë Shtet.

2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk do të zbatohen ndaj të ardhurave, që nuk janë të ardhura nga pasuria e paluajtshme të përcaktuara në paragrafin 2 të nenit 6, nëse përfituesi i këtyre të ardhurave, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron aktivitet në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selije të përhershme të vendosur aty, ose kryen në atë Shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur aty, dhe e drejta ose pasuria lidhur me të cilën paguhet shpërblimi është efektivisht e lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 14, si të paraqitet rasti.

Neni 22
Kapitali

1. Kapitali i përfaqsuar nga pasuri të paluajtshme që i referohen Nenit 6, të zotëruara nga një rezident i një Shteti Kontraktues dhe të vendosura në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen në këtë Shtet tjetër.

2. Kapitali i përfaqsuar nga pasuri të luajtshme që bëjnë pjesë në pasurinë e biznesit të një selije të përhershme që një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues ose nga pasuri të luajtshme që i përkasin një baze fikse në dispozicion të një rezidenti të një Shteti Kontraktues në Shtetin tjetër Kontraktues për kryerjen e shërbimeve personale të pavarura, mund të tatohen në këtë Shtet tjetër.

3. Kapitali i përfaqsuar nga anijet dhe avionët që veprojnë në trafikun ndërkombëtar, dhe nga pasuritë e luajtshme që i përkasin aktivitetit të këtyre anijeve dhe avionëve do të tatohen vetëm në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet vendi i drejtimit efektiv të sipërmarrjes.

4. Të gjithë elementet e tjerë të kapitalit të një rezidenti të një Shteti Kontraktues do të tatohen vetëm në këtë Shtet.

Neni 23
Eleminimi i tatimit të dyfishtë

1. Në rastin e Shqipërisë, tatimi i dyfishtë do të shmanget si vijon:

a) Kur një rezident i Shqipërisë realizon të ardhura ose zotëron kapitale të cilat, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente mund të tatohen në Zvicër, Shqipëria do të lejojë një reduktim nga tatimi i saj mbi të ardhurat e këtij rezidenti të një shume të barabartë me tatimin mbi të ardhurat të paguar në Zvicër dhe një reduktim nga tatimi mbi kapitalin e atij rezidenti të një shume të barabartë me tatimin mbi kapitalin të paguar në Zvicër. Megjithatë, ky reduktim nuk do të kalojë atë pjesë të tatimit Shqiptar mbi të ardhurat ose mbi kapitalin të llogaritur para dhënies së reduktimit, që i atribuohet, sipas rastit, të ardhurave ose kapitalit që mund të tatohet në Zvicër.

b) Kur në përputhje me dispozitat e Konventës të ardhurat e realizuara ose kapitali i zotëruar nga një rezident i Shqipërisë përjashtohet nga tatimi në Shqipëri, në llogaritjen e tatimit mbi të ardhurat ose kapitalin e mbetur të këtij rezidenti, Shqipëria merr në konsideratë të ardhurat ose kapitalin e përjashtuar.

2. Në rastin e Zvicrës, tatimi i dyfishtë do të shmanget si vijon:

a) Kur një rezident i Zvicrës realizon të ardhura ose zotëron kapitale të cilat, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, mund të tatohen në Shqipëri, Zvicra, duke mos cënuar dispozitat e nënparagrafit b, do të përjashtojë nga tatimi këto të ardhura apo kapitale, por mundet që, në llogaritjen e tatimit mbi pjesën e mbetur të të ardhurave apo kapitalit të atij rezidenti, të zbatojë nivelin e tatimit që do të zbatohej nëse të ardhurat apo kapitali i përjashtuar nuk do të ishin përjashtuar.

b) Kur një rezident i Zvicrës realizon të ardhura nga dividentët, interesat apo honoraret, të cilat në përputhje me dispozitat e neneve 10, 11 ose 12 mund të tatohen në Shqipëri, Zvicra, me kërkesë të këtij rezidenti, do të bëjë një lehtësim nga tatimi të këtij rezidenti. Ky lehtësim mund të konsistojë në:

(i) një reduktim nga tatimi mbi të ardhurat e atij rezidenti të një shume të barabartë me tatimin e vjelur në Shqipëri në përputhje me dispozitat e neneve 10, 11 ose 12; megjithatë, një reduktim i tillë nuk do të kalojë atë pjesë të tatimit Zviceran, të llogaritur përpara dhënies së reduktimit, që i takon të ardhurave që mund të tatohen në Shqipëri; ose

(ii) një reduktim të shume një fikse nga tatimi Zviceran; ose

(iii) një përjashtim pjesor i këtyre dividentëve, interesave apo honorareve nga tatimi Zviceran, duke konsistuar në çdo rast të paktën në reduktimin e tatimit të vjelur në Shqipëri nga shuma bruto e dividentëve, interesave apo honorareve.

Zvicra do të përcaktojë lehtësimin e aplikueshëm dhe do të rregullojë proçedurën në përputhje me dispozitat Zvicerane lidhur me zbatimin e konventave ndërkombëtare të Konfederatës Zvicerane për shmangien e tatimeve të dyfishta.

c) Një shoqëri që është rezidente Zvicerane dhe që realizon dividentë nga një shoqëri që është rezidente e Shqipërisë, për qëllimet e tatimit Zviceran mbi këto dividentë, do të gëzojë të njëjtat lehtësi që do t'i jepeshin shoqërisë nëse shoqëria paguese e dividentëve do të ishte rezidente e Zvicrës.

Neni 24

Mosdiskriminimi

1. Nënshtetasit e një Shteti Kontraktues nuk do të jenë, në Shtetin tjetër Kontraktues, subjekt i ndonjë tatimi ose kërkese të lidhur me të që të jetë i ndryshëm ose më i rëndë se sa tatimi dhe kërkesat e lidhura me të, të cilave i nënshtrohen ose mund t'i nënshtrohen nënshtetasit e këtij Shteti tjetër në rrethana të njëjta, veçanërisht lidhur me rezidencën. Kjo dispozitë, pavarësisht nga dispozitat e nenit 1, do të zbatohet gjithashtu ndaj personave që nuk janë rezidentë të njërit apo asnjërit prej Shteteve Kontraktuese.

2. Tatimi i një selije të përhershme që një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues nuk do të jetë më pak i favorshëm në këtë Shtet tjetër se sa tatimi i vjelur ndaj sipërmarrjeve të këtij Shteti tjetër që ushtrojnë aktivitete të njëjta. Kjo dispozitë nuk do të merret si detyrim i njërit Shtet Kontraktues për t'i garantuar rezidenteve të Shtetit tjetër Kontraktues lehtësime personale apo reduktime tatimore që i garanton rezidenteve të Shtetit të vet për gjendjen civile dhe përgjegjësitë familiare që ata kanë.

3. Përjashtuar rastet kur zbatohen dispozitat e nenit 9, paragrafit 6 të nenit 11 ose paragrafit 6 të Nenit 12, interesat, honoraret dhe shpërblime të tjera të paguara nga një sipërmarrjeje e një Shteti Kontraktues një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, për efekt të përcaktimit të fitimeve të tatueshme të kësaj sipërmarrje, do të jenë të reduktueshme nën të njëjtat kondita njëlloj sikur ato t'i paguheshin një rezidenti të Shtetit të përmendur në fillim. Në mënyrë të ngjashme, çdo borxh i një sipërmarrjeje të një Shteti Kontraktues ndaj një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, për efekt të përcaktimit të kapitalit të tatueshëm të kësaj sipërmarrjeje, do të jetë i reduktueshëm nën të njëjtat kondita, njëlloj sikur sipërmarrja të kishte kontraktuar me një rezident të Shtetit të përmendur në fillim.

4. Sipërmarrjet e një Shteti Kontraktues, kapitali i të cilave është totalisht ose pjesërisht i zotëruar apo kontrolluar, direkt ose indirekt, nga një ose më shumë rezidentë të Shtetit tjetër Kontraktues, nuk do të jenë në Shtetin e përmendur në fillim subjekt i ndonjë tatimi ose kërkese të lidhur me të, që të jetë i ndryshëm ose më i rëndë se sa tatimi ose kërkesat e lidhura me të, të cilave i nënështrohen ose mund t'i nënështrohen sipërmarrje të tjera të ngjashme të Shtetit të përmendur në fillim.

5. Dispozitat e këtij neni, pavarësisht nga dispozitat e nenit 2, do të zbatohen ndaj tatimeve të çdo

lloji.

Neni 25
Procedura e mirëkuptimit reciprok

1. Kur një person mendon se veprimet e njërit apo e të dy Shteteve Kontraktuese e rëndojnë apo do ta rëndojnë atë me tatime që nuk janë në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, pavarësisht nga mënyrat e ankimit të parashikuara në legjislacionin e brendshëm të këtyre Shteteve, ai mund ta paraqesë rastin e tij autoriteteve kompetente të Shtetit Kontraktues rezident i të cilit ai është, ose nëse çështja ka të bëjë me paragrafin 1 të nenit 24, ai mund ta paraqesë atë Shtetit Kontraktues, nënshtetas i të cilit ai është. Çështja duhet të paraqitet brenda tre vjetëve nga njoftimi i parë lidhur me veprimin që ka rezultuar në tatimin që nuk është në përputhje me dispozitat e Konventës.

2. Autoriteti kompetent, nëse kërkesa i duket e justifikuar dhe ai vetë nuk e ka të mundur arritjen e një zgjidhje të kënaqshme, do të përpiqet ta zgjidhë çështjen me mirkuptim reciprok me autoritetin kompetent të Shtetit tjetër Kontraktues, me synim shmangjen e tatimit që nuk është në përputhje me Konventën.

3. Autoritet Kompetente të Shteteve Kontraktuese do të përpiqen që me mirkuptim reciprok të zgjidhin çdo vështirësi apo dyshim që lind nga interpretimi apo zbatimi i Konventës. Ato gjithashtu mund të konsultohen së bashku për eleminimin e tatimit të dyfishtë në rastet kur një gjë e tillë nuk sigurohet nga Konventa.

4. Autoritet kompetente të Shteteve Kontraktuese mund të komunikojnë me njëri tjetrin direkt për arritjen e mirëkuptimit në kuptimin e paragrafëve të mësipërm. Kur shihet e arsyeshme që për arritjen e mirëkuptimit të zhvillohen shkëmbime direkte të opinioneve, ato mund të bëhen nëpërmjet një komisioni të përbërë nga përfaqësues të autoriteteve kompetente të Shteteve Kontraktuese.

Neni 26
Funksionarët diplomatikë dhe konsullorë

1. Dispozitat e kësaj Konvente nuk cënojnë privilegjet fiskale të funksionarëve diplomatikë dhe konsullorë që rrjedhin nga rregullat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare apo nga dispozita të marrëveshjeve të veçanta.

2. Pavarësisht nga dispozitat e Nenit 4, një individ që është anëtar i një misioni diplomatik, konsullor apo misioni të përhershëm të një Shteti Kontraktues i vendosur në Shtetin tjetër Kontraktues ose në një Shtet të tretë, për qëllime të kësaj Konvente, do të konsiderohet rezident i Shtetit dërgues nëqoftëse:

a) në përputhje me të drejtën ndërkombëtare ai nuk i nënshtrohet tatimit në Shtetin Kontraktues pritës lidhur me të ardhurat nga burime jashtë atij Shteti ose mbi kapitalin e vendosur jashtë atij Shteti, dhe

b) në Shtetin dërgues ai i nënshtrohet të njëjtave detyrime lidhur me tatimet mbi të ardhurat apo kapitalin e tij në total njëlloj si rezidentët e atij Shteti.

3. Konventa nuk do të zbatohet ndaj organizatave ndërkombëtare, organizmave dhe zyrtarëve të tyre dhe personave që janë anëtarë të misioneve diplomatike, konsullore apo të misioneve të përhershme të një Shteti të tretë, që janë prezent në njërin Shtet Kontraktues dhe nuk trajtohen në asnjërin Shtet Kontraktues si rezidentë lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin.

Neni 27
Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë do të ratifikohet dhe instrumentat e ratifikimit do të shkëmbehen sa më shpejt që të jetë e mundur.

2. Konventa do të hyjë në fuqi me shkëmbimin e instrumenteve të ratifikimit dhe dispozitat e saj do të kenë efekt:

a) në Shqipëri lidhur me të ardhurat e realizuara ose kapitalin e zotëruar më ose pas 1 janarit të

vitit që pason atë të hyrjes në fuqi të Konventës;

b) në Zvicër lidhur me të ardhurat e realizuara ose kapitalin e zotëruar më ose pas 1 janarit të vitit që pason atë të hyrjes në fuqi të Konventës.

Neni 28
Përfundimi

Kjo Konventë do të mbetet në fuqi deri në denoncimin nga njëri Shtet Kontraktues. Secili Shtet Kontraktues mund të përfundojë Konventën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, duke dhënë njoftimin e përfundimit të paktën 6 muaj përpara përfundimit të çdo viti kalendarik. Në rast të tillë, Konventa do të pushojë së pasuri efekt:

a) në Shqipëri lidhur me të ardhurat e realizuara ose kapitalin e zotëruar më ose pas 1 janarit të vitit që pason atë të dhënies së njoftimit të përfundimit;

b) në Zvicër lidhur me të ardhurat e realizuara më ose pas 1 Janarit të vitit që ndjek atë në të cilin është dhënë njoftimi i përfundimit.

Me dëshmitarë të pranishëm, nënshkruesit, posaçërisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në dy kopjo në Bernë, më 12 nëntor, 1999, në gjuhën shqipe, gjermane dhe angleze, të gjitha tekstet janë të barabarta. Në rast të ndonjë divergjence në interpretim midis tekstit në gjuhën gjermane dhe atij në gjuhën shqipe, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SE SHQIPËRISË	PËR KËSHILLIN FEDERAL ZVICERAN

L I G J
Nr. 8598, datë 6.4.2000

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE AGJENCISË FEDERALE GJERMANE, THW, PËR NDIHMË TEKNIKE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Agjencisë Federale Gjermane, THW për ndihmë teknike"

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2605, datë 19.4.2000 të Presidentit të Republikës të Shqipërisë, Rexhep Meidani.

MARRËVESHJE

Ndërmjet Agjencisë Federale për Ndihmë Teknike THW
(Bundesanstalt Techisches Hilfswerk)
dhe
Qeverisë së Republikës të Shqipërisë në ndihmë humanitare
për refugjatët nga Kosova në Shqipëri dhe përmirësimin e objekteve
dhe infrastrukturës pas krizës kosovare

Një Marrëveshje kjo, e arritur më 21 Janar 2000, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë (tani e tutje e referuar si "Qeveria" nga njëra anë dhe Agjencisë Federale për Ndihmë Teknike – THW (Bundesantstalt Techisches Hilfswerk) organizatë për ndihmë teknike humanitare në rast fatkeqësie (tani e tutje e referuar si "THW") nga ana tjetër, mbi planifikimin, përgatitjen, zbatimin dhe financimin e projekteve për ndihmë Humanitare në Republikën e Shqipërisë.

Ku, Qeveria mirëpret, vazhdimin në territoret e saj të Projekteve të Ndihmës Humanitare nga THW, dhe gadishmërinë e saj për projekte teknike humanitare të mëtejshme;

Ku, THW ka bashkëpunuar dhe ka dhënë ndihmë në shumë vende të Europës me projekte të ndryshme teknike si ndihmë humanitare dhe ka si qëllim të vazhdojë një bashkëpunim dhe ndihmë të tillë;

Ku, THW është forca në detyrë e Qeverisë Federale të Gjermanisë për Ndihmë Teknike dhe Humanitare në raste fatkeqësie, e cila vepron brenda 72 orëve nga koha e kërkuar në rrethana urgjente për të dhënë ndihmë të menjëhershme;

Ku, THW ka kërkuar të hapë një Zyrë Ndërmjetëse (Zyrë e Përgjegjësit të saj të Misionit në Shqipëri) në Tiranë, me qëllim që të koordinojë aktivitetet e saj në Shqipëri dhe aktivitetet në Zyrat rajonale të vendosura në pjesët e tjera të Europës Jugore si dhe me qendrën në Bonn/Gjermani;

Ku, THW dëshiron të përmbushë një numër të caktuar të projekteve si Ndihmë Humanitare në vend, në favor të refugjatëve nga Kosova;

Ku, THW dëshiron të hapë Zyra Lokale në Shqipëri me një magazinë për pajisjet teknike dhe automjetet;

Dhe ku Qeveria e ka pranuar këtë kërkesë;

Dhe si Rezultat Qeveria dhe THW bien dakord si më poshtë:

ARTIKULLI I
HAPJA E DY ZYRAVE

THW është e autorizuar nga Qeveria të hapë një Zyrë Ndërmjetëse në Tiranë dhe Zyra Lokale në Shqipëri, bashkë me ato të Zyrave të tjera të saj Rajonale, Vendore dhe Nënzyrave të vendosura në pjesë të tjera të botës dhe Qendrës së saj në Bonn, Gjermani, Zyra Lokale përveç të tjerave përfshi bazat logjistike me një magazinë.

ARTIKULLI II
OBJEKTIVAT E THW

Shprehja në Shqip për TECHNISCHES HILFSWERK – THW – është:

Agjencia Federale për Ndihmë Teknike – THW.

THW (Technisches Hilfswerk) është Organizatë Qeveritare për ndihmë në raste fatkeqësie e Republikës Federale Gjermane. Është krijuar nga ligji federal në 1953 dhe është një Agjenci Federale brenda parashikimit të Ministrisë së Brendshme Federale. Drejtori i THW-së dhe qendra e tij është e vendosur në Bonn.

Funksionet Zyrtare

Funksionet e THW-së janë të përcaktuara në ligjin Federal Gjerman.

Jashtë vendit këto funksione konsistojnë në sigurimin e asistencës teknike në sektorët e lehtësimit në raste fatkeqësish dhe ndihmës Humanitare Ndërkombëtare.

Fushat kryesore të aktivitetit janë shpëtimi, zgjedhja dhe rehabilitimi i infrastrukturës (ujit, sistemit elektrik, ujrave të zeza dhe banesave).

Struktura

Janë nën varësi të drejtorisë së qendrës së THW-së

8 Zyra Komisionare Shtetërore

66 Komisionerë Rajonalë

665 Ndarje Lokale me Komisionerë Lokalë vullnetarë

nga struktura e organizimit të THW në Gjermani. Kjo strukturë organizon më shumë se 44.000 vullnetarë aktivë, 17.000 vullnetarë rezervë dhe 10.000 vullnetarë të ri.

Detyrat Ndërkombëtare

THW do të mbështesë Qeveritë, Bashkimin Europian dhe/ose sistemin e Kombeve të Bashkuara në Europë, Vendet Arabe dhe Afrikane në ndihmë teknike në raste të fatkeqësive dhe/ose rehabilitimit emergjent të infrastrukturës me urdhër të Qeverisë Federale Gjermane.

ARTIKULLI III
EMËRIMI I ZYRTARIT NDËRMJETËS TË THW PËR ZYRËN NDËRMJETËSE NË TIRANË/SHQIPËRI

a) Zyra ndërmjetëse do të veprojë nën drejtimin e Përgjegjësit të Misionit në Shqipëri, i cili do të emërohet nga Drejtori i THW-së. Përgjegjësi i Misionit do të jetë përfaqësuesi zyrtar i THW-së.

b) Me miratimin dy palësh me autoritetet e THW, Përgjegjësi i Misionit do të sygjerojë stafin e ndihmës që nevojitet për të përfunduar aktivitetet e saj. Emërimet do të bëhen përmes Qendrës në Gjermani.

ARTIKULLI IV
SIPËRMARRJA E QEVERISË PËRSA I PËRKET THW

Për këtë Qeveria bie dakord dhe merr përsipër:

(a) T'i sugjerojë THW të njëjtat privilegje, lehtësi dhe përjashtime nga taksat dhe tatimet e çdo lloji në Shqipëri (përfshirë taksat doganore dhe tatimin mbi vlerën e shtuar) njëlloj me përfaqësitë e organizmave të tjera humanitare të njohura ndërkombëtare që operojnë në Shqipëri si Kryqi i Kuq Ndërkombëtar, UNHCR etj;

(b) të përjashtojë THW nga të gjitha ndërhyrjet e rrethanave burokratike, të cilat mund të pengojnë THW, që të veprojë menjëherë në raste urgjente;

(c) të garantojë dërgimin e menjëhershëm në rast importi, importi ose eksporti të përkohshëm nga ose për tek shtetet që kërkojnë shërbimin e THW;

(d) të përjashtojë THW nga të gjitha ndalimet dhe kufizimet në import, import dhe eksport të përkohshëm përsa u përket artikujve të importuar ose eksportuar nga THW për përdorimin e saj zyrtar në lidhje me sigurimin e publikimeve të artikujve të thënë që janë importuar ose eksportuar më parë përmes taksës doganore;

(e) të përjashtojë personat e përmendur nga çdo ndalim ose arrestim në lidhje me veprime apo mosveprime, të cilat lidhen me kryerjen e detyrave që atyre u ngarkohen sipas kësaj marrëveshjeje;

(f) THW duhet të ketë të drejtën të importojë ose eksportojë përkohësisht materialet e saj, pajisjet

veglat e tjera, si dhe mjetet e transportit pasi janë të nevojshme për shfrytëzim nga ajo;

(g) të përjashtojë stafin jo shqiptar të THW nga tatimet mbi të ardhurat personale dhe nga kontributet në sistemin e sigurimeve shoqërore. Për punonjësit shqiptar (lokal) në THW, kjo e fundit duhet të llogarisë dhe të paguajë tatimin mbi pagat dhe kontributin e sigurimeve shoqërore, në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar;

(h) të parashikojë THW nga detyrimet doganore në import, eksport dhe import të përkohshëm të publikimeve të THW duke përfshirë foto dhe filmat, aparatet e regjistrimit, programe për shfrytëzim kompjuteri, të dhënat dhe pajisjet të lidhura me aktivitetin e THW;

(i) të ndihmojë THW dhe anëtarët e stafit të Zyrës Ndërmjetëse dhe atyre Lokale, këshillues dhe konsulentë me detyrë në Shqipëri dhe t'i pajisë ato, nëse gjykohet e nevojshme me karta identiteti ose dokumente të tjera të domosdoshme në mënyrë që të lehtësojë kryerjen e detyrave të tyre sipas kësaj Marrëveshjeje;

(j) të autorizojë THW të operojë llogari të tilla bankare në monedhë të huaj dhe të marrë përsipër operacione të bursës së huaj sikurse mund të kërkohet në mënyrë që të kryej në mënyrë të kënaqshme aktivitetet e saj ndërkombëtare që janë subjekti i çdo lloj shkëmbimi të kontrollit të ligjeve dhe rregullave për periudhën që do të jetë në fuqi në Shqipëri;

(k) të ndihmojë ku të jetë e mundur për të siguruar funksion të mirë të komunikimit zyrtar të THW;

(l) t'i lejojë THW të përdorë çdo lloj radioje dhe mjete të tjera komunikimi satelitor;

(m) t'i japë stafit vendas dhe atij të huaj të THW, makina, kamione, pajime, vegla makinerie, plaçka dhe materiale personale, të gjithë mbrojtjen e kërkuar jashtë çmimit në rast se nevoja të tilla mund të ngrihen;

(n) të bëjë të vlefshme për THW pa ndonjë lloj çmimi ambientet (troje dhe objekte ndërtimi) të konsideruara në këtë projekt dhe të sigurojë që nuk ka të drejta pronësie të një personi të tretë.

ARTIKULLI V
SIPËRMARRJET E THW

THW bie dakord të marrë përispër:

(a) të konsultohet me Qeverinë përsa i përket caktimit të stafit dhe ekspertëve jo Shqiptar në Shqipëri dhe të informojë Qeverinë për caktimin e stafit profesional në Zyrën Ndërmjetëse në Tiranë, aktivitetet e saj kryesisht të lidhura me ndihmën në Shqipëri;

(b) të marrë të gjitha hapat e arsyeshëm për të siguruar që anëtarët e stafit të saj, këshilluesit ose konsulentët në Shqipëri të mos angazhohen në aktivitete që janë të papajtueshme me qëllimet dhe objektivat e THW ose në kundërvënie me ligjet dhe rregullat shqipëtare;

(c) t'i nënshtrohet konsultimit dypalësh midis Qeverisë dhe THW dhe sipas kërkesës së shprehur nga Qeveria, të vendosë për rikthimin e një anëtari stafi, këshilluesi ose konsulenti me detyrë në Shqipëri në qoftë se një anëtar stafi, këshillues ose konsulent i tillë përfshihet në dhunime serioze të ligjeve dhe rregullave të Shqipërisë ose në një aktivitet, i cili është i papajtueshëm me qëllimin e THW;

(d) të marrë të gjitha përgjegjësitë për pajisjet dhe automjetet e saj, të cilat janë në pronësi të Qeverisë Federale Gjermane, shitjet e të cilave janë të ndaluara;

(e) të marrë të gjitha përgjegjësitë për ndonjë këmbim të materialeve të saj, vetë me urdhër të ministrisë së Brendshme Gjermane, sipas marrëveshjes me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Gjermanisë dhe partnerit kërkues si KB ose KE dhe të informojë Qeverinë menjëherë rreth kësaj gjëje;

(f) të konsultohet me Autoritet Doganore në raste ndarjeje të automjeteve ose pajisjeve të dëmtuara ose me difekt;

(g) të punësojë persona vendas për një sërë punësh të nevojshme te Zyra Ndërmjetëse Lokale ose Magazina të THW;

(h) të përshtasë kapacitetet teknike, materiale dhe personale të zyrës ndërmjetëse me nevojat dhe aktivitetet ndihmëse në çdo moment;

(i) të kordinojë të gjitha aktivitetet e projekteve me UNHCR si Agjenci Drejtuese e Ndihmës

Humanitare për refugjatët kosovarë dhe të veprojë brenda limiteve strikte të mandatit humanitar të UNHCR.

ARTIKULLI VI
SIPËRMARRJET E QEVERISË NË LIDHJE ME ANËTARËT E STAFIT, KËSHILLUESVE OSE KONSULENTËVE QË NUK JANË SHTETAS SHQIPTARË

Në lidhje me përgjegjësin e Misionit, anëtarët e stafit, këshilluesve dhe personelit tjetër të THW, të cilët nuk janë shtetas shqiptar ose rezident në Shqipëri përveç qëllimit të kësaj Marrëveshjeje, Qeveria merr përsipër:

(a) të garantoj përjashtimin nga taksat direkte, kontributet e sigurimit shoqëror në të ardhura, pagave ose pagesave të tjera të marra nga ata prej THW;

(b) t'i përjashtojë ato nga pagesat e importit, doganave dhe detyrimeve të tjera për mjetet e tyre të reja ose të përdorur qofshin ato personale apo familjare (duke përfshirë një mjet transporti) të importuara nga ata brenda tre muajve të arritjes së tyre në Shqipëri apo në raste të veçanta sikurse në një periudhë të vonë që Qeveria mund të miratojë me shkrim prezantimin e bërë nga THW. Në rast se mallra të tilla janë shitur ose shfrytëzuar në Shqipëri prej tjetërkujt, përveç se personelit ose organizatës njësoj të privilegjuar, detyrimet tatimore dhe doganore do të paguhen në përputhje me dispozitat përkatëse;

(c) t'u garantojë atyre përjashtimin nga detyrimet e shërbimit kombëtar, regjistrimet e huaja, kufizimet imigruese dhe t'i pajisë ato me leje të përhershme pune dhe hyrjeje në Shqipëri;

(d) të zgjerojë mundësi të tilla të riatdhesimit në kohërat e krizave, ashtu sikurse janë zgjeruar nga Qeveria për personelin e ndihmës teknike;

(e) të lejojë ata ose vartësit e tyre të sjellin në Shqipëri një shumë të arsyeshme të monedhës së huaj për shfrytëzimin personal, të tërheqë dhe riatdhesojë shuma të tilla nga Shqipëria, sipas mundësive të llogarive të jashtme në përshtatje me rregullat mbizotëruese të bursës në Shqipëri;

(f) t'u japë atyre lirinë në udhëtim, lëvizje dhe komunikim që është e nevojshme për përfundimin e kënaqshëm të detyrave të tyre në marrëveshje.

ARTIKULLI VII
HYRJA NË FUQI

(1) Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi me ratifikimin e saj nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

(2) Kjo marrëveshje mund të rishikohet ose të modifikohet me kalimin e kohës nga konsultime dhe miratime dypalëshe.

(3) Çdo rishikim ose modifikim i kësaj marrëveshje duhet të bëhet me shkrim.

ARTIKULLI VIII
TË NDRYSHME

Çdo çështje që nuk është parashikuar në marrëveshjen e tanishme do të përcaktohet në përshtatje me një marrëveshje ndërmjet dy qeverive, shqiptare dhe asaj gjermane, nëse është e nevojshme.

Kjo marrëveshje do të mbetet në fuqi për kohëzgjatjen totale të aktiviteteve të tanishme.

Ajo mund të rinovohet për periudha të tjera të aktivitetit ndërmjet shkëmbimeve të thjeshta të letrave midis Qeverisë dhe THW, po të mos përfundohet nga njëra prej palëve, gjë e cila do të ndodhë brenda gjashtë muajve pas paraqitjes me shkrim, tendencës së njërës palë tek tjetra.

Bërë në Tiranë më 20 janar 2000.

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë	Për Agjencinë Federale të Shërbimit Teknik

Blendi Klosi

Technical Relief – THW
Përgjegjësi i Misionit në Shqipëri
Dr.Thomas Hönicke

Kjo kontratë është përfunduar në gjashtë kopje.
- Tre kopje për Qeverinë Shqiptare
- Një kopje për Ambasadën Gjermane në Tiranë
- Një kopje për Ministrinë e Punëve të Brendshme.
- Një kopje për THW në Bonn/Germany.

L I G J
Nr. 8600, datë 10.4.2000

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR.8454, DATË 4.2.1999
"PËR AVOKATIN E POPULLIT"

Në mbështetje të neneve 60-63, 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.8454, datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit", në nenin 35 shtohet paragrafi i dytë me këtë përmbajtje:
"Struktura dhe organika e zyrës së Avokatit të Popullit caktohet nga Avokati i Popullit."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2598, datë 17.4.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

L I G J
Nr. 8601, datë 10.4.2000

PËR NJË NDRYSHIM NË KODIN E PROCEDURËS CIVILE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Në Kodin e Procedurës Civile, neni 35 paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

"Gjykata e rrethit gjykon me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar ose tre gjyqtarë.

Me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë gjykohen këto çështje:

a. Paditë për njohjen e të drejtës së pronësisë dhe të të drejtave reale mbi sendet e paluajtshme.

b. Paditë për kërkimin e sendeve të paluajtshme dhe pjesëtimin e tyre.

c. Paditë për pavlefshmërinë e veprimeve juridike, kur objekti i tyre është mbi 5 milionë lekë.

ç. Paditë për njohjen, kërkimin dhe pjesëtimin e trashëgimisë, kur vlera e padisë është mbi 5 milionë lekë.

d. Paditë që rrjedhin nga mosekzekutimi ose ekzekutimi jo në mënyrë të plotë i detyrimeve për shpërblimin e dëmit, për begatimin pa shkak dhe për pagimin e padetyruar, kur vlera e padisë është mbi 5 milionë lekë.

dh. Paditë që rrjedhin nga mosmarrëveshjet tregtare të parashikuara nga neni 334 i këtij Kodi.

e. Paditë për kundërshtimin e akteve administrative, me përjashtim të atyre që rregullojnë marrëdhëniet e punës ose që përmbajnë detyrime në të holla deri në 5 milionë lekë.

ë. Paditë për shpalljen e zhdukjes ose të vdekjes së personit.

f. Paditë për heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar të personave.

Çështjet e tjera gjykohen nga një gjyqtar i vetëm."

Neni 2
Dispozita kalimtare

Çështjet civile që janë në gjykim në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që sipas tij duhet të gjykohen nga një gjyqtar i vetëm, do të vazhdojnë të gjykohen nga gjyqtari që ka kryesuar trupin gjykues, duke u njohur të vlefshme veprimet procedurale të kryera deri në atë çast.

Për çështjet civile që janë në gjykim në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe duhet të gjykohen me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, për formimin e trupit gjykues do të veprohet si vijon:

Kur dy gjyqtarët që zëvendësojnë ndihmësgjyqtarët, pasi njihen me materialet e çështjes, japin pëlqimin që hetimi gjyqësor të vazhdojë aty ku është ndërprerë dhe palët nuk kanë kundërshtim, trupi gjykues vendos vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor të çështjes, duke i njohur të vlefshme veprimet procedurale të kryera deri në atë çast.

Kur së paku njëri nga gjyqtarët që zëvendëson ndihmësgjyqtarin ose njëra nga palët kërkon që shqyrtimi gjyqësor të rifillojë nga e para, trupi gjykues vendos rifillimin nga e para të shqyrtimit gjyqësor.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2599, datë 17.4.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

L I G J
Nr.8602, datë 10.4.2000

PËR NJË NDRYSHIM NË KODIN E PROCEDURËS PENALE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Në Kodin e Procedurës Penale, neni 13 paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

"2. Gjykatat e rretheve dhe ato ushtarake gjykojnë me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar i vetëm kur shqyrtojnë vepra penale për të cilat parashikohet dënim me gjobë ose burgim në maksimum jo më të lartë se pesë vjet. Veprat e tjera penale gjykohen me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë."

Neni 2
Dispozitë kalimtare

Kundërvajtjet penale që janë në gjykim në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që sipas tij duhet të gjykohen nga një gjyqtar i vetëm, do të vazhdojnë të gjykohen nga gjyqtari që ka kryesuar trupin gjykues, duke u njohur të vlefshme veprimet procedurale të kryera deri në atë çast.

Krimet që janë në gjykim në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe për të cilat parashikohet dënim me gjobë ose burgim në maksimum jo më të lartë se pesë vjet, do të vazhdojnë të gjykohen nga një trup gjykues i përbërë nga tre gjyqtarë.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2600, datë 17.4.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

D E K R E T
Nr. 2597, datë 17.4.2000

PËR LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c", të Kushtetutës, të neneve 15,19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 05.08.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

D E K R E T O J

Neni 1

U hiqet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Isuf Muharrem Hoxha

2. Erdit Fatmir Çaku
3. Diana Jak Abdija (Marku)
4. Sotiraq Koço Qyqe
5. Besnik Nebi Nuredikaj
6. Enida Besnik Nuredikaj
7. Selim Maliq Zekaj
8. Diana Çesk Niemann (Vuka)
9. Ismet Halim Gjylsheni
10. Fatma Fatos Kruezi (Shingjini)
11. Petraq Efthim Naumi
12. Hamit Lutfi Bytyçi
13. Mishel Ibrahim Beka
14. Arben Shefqet Shima
15. Ludovik Ndre Demaj
16. Klaudia Ludovik Demaj
17. Gabriela Ludovik Demaj
18. Edlira Kol Demaj (Cima)
19. Arben Nexhmi Ballka
20. Ilir Bardhyl Morina
21. Altin Xhemal Kareçi
22. Alessia Altin Kareçi
23. Liri Tefik Velaj
24. Eleonora Ramiz Pema
25. Aqif Refat Ibrahimi
26. Avni Refat Ibrahimi
27. Linda Çesk Franja

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Rexhep Meidani

V E N D I M
Nr. 428, datë 16.2.2000

PËR ZGJEDHJEN E AVOKATIT TË POPULLIT

Në mbështetje të nenit 63, pika 1 të Kushtetutës dhe të nenit 92 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

I. Zoti Ermir Dobjani zgjidhet në detyrën e Avokatit të Popullit.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Skënder Gjinushi

VENDIM
Nr. 429, datë 17.2.2000

PËR CAKTIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË POSAÇËM TË KUVENDIT PËR PAKTIN E STABILITETIT

Në mbështetje të neneve 30 dhe 88 të Rregullores së Kuvendit dhe të Vendimit të Kuvendit nr.427, datë 27.1.2000 "Për caktimin e Komisionit të Posaçëm të Kuvendit për Paktin e Stabilitetit",

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

I. Komisioni i Posaçëm i Kuvendit për Paktin e Stabilitetit përbëhet nga këta anëtarë:

1. Fatos Nano	PS
2. Pandeli Majko	PS
3. Hamdi Jupe	PS
4. Arben Malaj	PS
5. Arta Dade	PS
6. Sokol Hazizi	PS
7. Pavli Zëri	PSD
8. Ligoraq Karamelo	PDNJ
9. Nikoll Lesi	I pavarur
10._____	PD
11. _____	PD
12. _____	PD
13. _____	E Djathta e Bashkuar

II. Kryetar i Komisionit të Posaçëm të Kuvendit për Paktin e Stabilitetit zgjidhet zoti Fatos Nano dhe Sekretar zoti Pavli Zëri.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Skënder Gjinushi

V E N D I M
Nr. 430, datë 17.2.2000

PËR PËRCAKTIMIN E RAPORTEVE TË PAGËS, TË SHPËRBLIMIT DHE TË NORMËS SË TRANSPORTIT TË DEPUTETËVE

Në Mbështetje të nenit 13 pika 4 të ligjit nr.8550, datë 18.11.1999 "Statusi i deputetit" dhe të nenit 88 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit të Mandateve, Imunitetit dhe Rregullores,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

1. Paga e deputetit përcaktohet sipas ligjit nr.8550, datë 18.11.1999 "Statusi i deputetit". 15 për qind e kësaj page i jepet deputetit në vartësi të pjesëmarrjes së tij në seancat plenare të Kuvendit.

2. Përveç pagës bazë, deputeti shpërblehet:

2.1. për pjesëmarrje në mbledhjet e komisionit të përhershëm ku bën pjesë. Për këtë rast, masa e shpërblimit është 1000 lekë për mbledhje, por jo më shumë se 10 mbledhje në muaj.

2.2. si kryetar i komisionit ose i nënkomisionit të përhershëm të Kuvendit (drejtues i mbledhjes së radhës). Masa e shpërblimit si kryetar i komisionit të përhershëm është 1200 lekë dhe si kryetar i nënkomisionit 1100 lekë për mbledhje;

2.3. si kryetar i grupit parlamentar 5-15 për qind mbi pagën e deputetit në raport me numrin e anëtarëve të grupit;

3. Norma e transportit për deputetët përcaktohet me rregullore të veçantë. Ajo duhet të sigurojë pjesëmarrjen e tyre në punimet e Kuvendit dhe vajtjen në zonën elektorale.

4. Masa e dietës që përfiton deputeti kur shkon me shërbim jashtë shtetit nga Kuvendi është 60 USD për ditë të plotë.

5. Efektet financiare të këtij vendimi të llogariten që nga data 1.1.2000

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Skënder Gjinushi

V E N D I M
Nr. 154, datë 7.4.2000

PËR LICENSIMIN E VEPRIMTARIVE PRODHUESE NË INDUSTRINË JOUSHQIMORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991, "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe të privatizimit", me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privtizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Licensimi i personave fizikë dhe juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari prodhuese në industrinë joushqimore, të bëhet nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

2. Licensimi i veprimtarisë prodhuese realizohet me dhënien e lejes "Për ushtrimin e veprimtarisë prodhuese në industrinë joushqimore".

Afati i lejes është 5 vjet. Kjo leje mund të përsëritet dhe të hiqet, në përputhje me rregullat në fuqi.

3. Veprimtaritë prodhuese të industrisë joushqimore, që licensohen, përfshijnë degët:

a. Metalurgji-mekanike;
b. Lëkurë-këpucë
c.Tekstil-konfeksione;
ç. Gomë-plastike;
d. Qelq-qeramike;
dh. Dru-letër;

e. Kimikate të tjera.

4. Subjektet, të cilat kërkojnë të zhvillojnë veprimtari prodhuese në degët e përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi, duhet të plotësojnë specifikimet teknike dhe të zbatojnë rregullat teknike, përkatëse.

Kontrolli i zbatimit të rregullave teknike bëhet nga inspektoriatet dhe nga organet e specializuara, shtetërore.

5. Afati i pajisjes së subjekteve me lejen "Për ushtrimin e veprimtarisë prodhuese në industrinë joushqimore" është 30 ditë nga data e paraqitjes së dokumentacionit përkatës.

6. Subjektet, të cilat sot ushtrojnë veprimtari prodhuese në industrinë joushqimore pa lejen përkatëse, janë të detyruara të pajisen me leje deri më 31.12.2000. Vazhdimi i kësaj veprimtarie pa lejen përkatëse pas datës së mësipërme është i paligjshëm.

7. Pikat 1.2 e vendimit nr.295, datë 13.4.1994, të Këshillit të Ministrave, "Për forcimin e kontrollit cilësor në prodhimin, ruajtjen, transportimin dhe tregtimin e mallrave joushqimore", shfuqizohet.

8. Vendimi nr.198, datë 2.5.1997, i Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.621, datë 20.12.1993, "Për kompetencat në dhënien e lejeve për ushtrimin e veprimtarive në fushën e transportit"", ndryshuar me vendimin nr.763, datë 11.11.1996, shfuqizohet.

9. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit të nxjerrë udhëzimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr. 186, datë 21.4.2000

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.326, DATË 21.6.1993, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KRITERET E TRAJTIMIT TË INVALIDËVE TË LUFTËS KUNDËR PUSHTUESVE NAZIFASHISTË TË POPULLIT SHQIPTAR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 3, të ligjit nr.7663, datë 20.1.1993, "Për statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Paragrafi i dytë, pika 3, në vendimin nr.326, datë 21.6.1993, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si vijon:

"Këtë shtesë invalidi i luftës e merr edhe kur përfiton pension pleqërie. Kjo shtesë do t'u nënshtrohet të gjitha rritjeve që kanë pësuar dhe do të pësojnë pensionet për shkak të rritjes e të ndryshimit të çmimeve, duke filluar nga data 20 janar 1993.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi. Llogariten në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë dhe përballohen nga fondet e përcaktuara për shpërblimin e invalidëve dhe të veteranëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, në zërin "Financime", në buxhetin e miratuar për vitin 2000 për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr. 190, datë 21.4.2000

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.789, DATË 24.12.1998, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LISTËN E BARNAVE QË RIMBURSOHEN DHE MASËN E MBULIMIT TË ÇMIMIT TË BARNAVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, pika 3, të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994, "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimi nr.789, datë 24.12.1998, të Këshillit të Ministrave, në listën e barnave që rimbursohen nga sigurimet shëndetësore, të bëhen ndryshimet, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Efekti financiar, prej 18 000 000 lekësh, që rrjedh nga ndryshimi i kësaj liste, të përballohet nga buxheti i miratuar për vitin 2000 për Institutin e Sigurimeve Shëndetësore.
3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Sigurimeve Shëndetësore për zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

NDRYSHIMET E LISTËS SË BARNAVE QË RIMBURSOHEN
NGA SIGURIMET SHËNDETËSORE

Në listën e barnave që rimbursohen nga sigurimet shëndetësore

Shtohen artikujt:
1. Acidum ursodeoxycholicum 250 mg
2. Cyproteronum 100 mg inj.

Hiqen:
1. Të gjitha insulinat me origjinë animale
2. Acidum acetylsalicylicum 500 mg

Lihen:
Vetëm insulinat me origjinë humane

Ndryshohen:
1. Penicillaminum 250 mg ndryshohet në Penicillaminum 150 mg.

U dorëzua për shtyp më 27.4.2000
Doli nga shtypi më 28.4.2000

Tirazhi: 3700 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "Tipografia Ushtarake"

Çmimi: 150 lekë